



ORGANIZATA
TË NDRYSHËM & TË BARABARTË
Raporti Vjetor

2010



ORGANIZATA
TË NDRYSHËM & TË BARABARTË

©

TË GJITHA TË DREJTAT TË REZERVUARA -
ORGANIZATA "TË NDRYSHËM & TË BARABARTË"

RAPORTI U PËRGATIT NGA:

STAFI D&E

DIZAJNI GRATAFIK: *YLLKA GJIKOPULLI*

SHTËPIA BOTUESE: *KLEAN*



ORGANIZATA

TË NDRYSHËM & TË BARABARTË

Raporti Vjetor

2010

UN.GIFT

Global Initiative to Fight Human Traffic

*FINANCUAR NGA:
INICIATIVA GLOBALE E KOMBEVE TË BASHKUARA NË LUFTËN KUNDËR
TRAFIKIMIT TË QËNIEVE NJERËZORE*



FALENDERIME

Botimi i këtij raporti u mundësua nga mbështetja financiare e Iniciativës Globale të Kombeve të Bashkuara në luftën kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore (UN.GIFT) të cilët organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë” i falenderon.

Ne ju shprehim mirënjohje të veçantë të gjithë donatorëve që na kanë mbështetur për të ndihmuar viktimat e trafikimit e për ta zhvilluar e përmirësuar ndihmën në mënyrë të qëndrueshme si USAID, IOM, UN.GIFT, King Baudouin Foundation, Ministria e Jashtme e Norvegjisë, Ambasada Amerikane në Tiranë, Fondacioni Vodafone Albania, MIVA-Holand, SRTV Holand, , Ambasada e Australisë në Athinë, TIKa.

Falenderimet tona shkojnë gjithashtu për partnerët e organizatës, vullnetarët dhe bordin shumë të përkushtuar.

Mbi të gjitha, dëshirojmë të falenderojmë përfituesit e programit për kurajon e tyre drejt ri- integritit në jetën e pavarur.

Stafi i organizatës “Të ndryshëm & Të Barabartë”



PËRMBAJTJA

Hyrje	6-7
Mira: Një histori mbijetese	8
1.Kë ndihmojmë ne?	9
Përfitueset e programit	
Profili i viktimave të trafikimit	
Identifikimi dhe referimi	
Burimi i referimit për rastet e reja të asistuar gjatë 2010	
Mosha e përfitueseve	
Konteksti familjar	
Niveli i edukimit të viktimave të trafikimit	
2. Trendet e trafikimit dhe shfrytëzimit	17
Mënyrat e rekrutimit	
Rrugët e lëvizjes	
Vendet ku rastet janë trafikuar	
Llojet e shfrytëzimit për rastet e reja	
3. Çfarë bëjmë ne?	23
Projekti 1: “Ofrimi i asistencës riintegruese të qëndrueshme për ish viktimat shqiptare të trafikimit”	
Projekti 2: “Fuqizimi i nënave të reja, viktimave të trafikimit dhe dhunës, për të rritur fëmijë të shëndetshëm”	
Projekti 3: “Përmirësimi i kushteve të Qendrës së Riintegritimit për viktimat shqiptare të trafikimit”	
Projekti 4: “Rritja e aftësive për jetën të viktimave shqiptare të trafikimit përmes trajnimeve e aktiviteteve edukuese”	
4. Donatorët	44
5. Trajnime të ofruara për aktorë të tjerë	49
6. Pjesëmarrjet në aktivitete të ndryshme	50
7. Pasqyra financiare	54



HYRJE

D&E është një organizatë jo-fitimprurëse e përkushtuar për të dhënë shërbime cilësore për mbrojtjen dhe ri/integrimin e viktimave të abuzimit, të shfrytëzimit dhe të trafikimit, dhe për të ndryshuar kontekstin ligjor, institucional dhe social në mënyrë të tillë që ti kundërshtojë këto abuzime.

Planifikimi dhe zbatimi i aktiviteteve të organizatës “Të Ndryshëm & Të Barabartë” udhëhiqen dhe përmbushin linjat e strategjive dhe planeve të veprimit kombëtar për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore dhe detyrimet e organizatës si Anëtare e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për viktimat e trafikimit.

Gjatë vitit 2010, organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë”, nëpërmjet mbështetjes financiare nga donatorë kryesisht ndërkombëtarë, por edhe vendas, ka realizuar 4 projekte, të fokusuar në ndihmën direkte ndaj viktimave të trafikimit, si edhe grave e vajzave, viktimat të abuzimit.

Gjatë këtij viti, përveç ndihmës së drejtpërdrejtë, “Të Ndryshëm & Të Barabartë” ka dhënë gjithashtu kontribut në hartimin e politikave të rëndësishme në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore dhe dhunës me bazë gjinore siç janë Strategjia Kombëtare në Luftën kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore dhe Plani i Veprimit 2011-2013, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore 2011-2015, dhe përgatitjen e Procedurave Standarte të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave të Trafikimit.


Stafi i organizatës ka marrë pjesë në disa aktivitete për rritjen e kapacitetit profesional të organizuar nga vetë ne , por edhe nga donatorët dhe partnerët si IOM, KBF, etj. Stafi gjithashtu ka kontribuar për rritjen e kapacitetit të aktorëve të ndryshëm në ndihmë të viktimave të trafikimit siç janë trajnimet e organizuara për median, institucionet e zbatimit të ligjit apo shërbimet sociale.



Së bashku me anëtarët e tjerë të Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Antitrafik-(KKSAT) dhe me nxitjen e mbështetjen e partnerëve dhe donatorëve ndërkombëtarë, “Të Ndryshëm & Të Barabartë” ka bërë përpjekje të mëdha për të siguruar qëndrueshmërinë e programit të riintegritit për viktimat e trafikimit jo vetëm me kontribut të donatorëve ndërkombëtarë por edhe me kontribut të biznesit vendas dhe institucioneve shtetërore

Si rezultat i këtyre përpjekjeve, “Të Ndryshëm & Të Barabartë” ka patur rritje të financimeve nga donatorët ndërkombëtarë, dhe është financuar për vitin e dytë rradhazi nga një donator vendas nga fusha e biznesit sic është Fondacioni Vodafone në Shqipëri.

Me miratimin e Ligjit nr. 10252, datë 11. 03. 2010 “Për disa shtesa në ligjin nr.9355, datë 10.09.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore të ndryshuar” organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë”, është në proces të financimit me fonde të buxhetit të shtetit për plotësimin e nevojave ushqimore të viktimave të trafikimit të akomoduar në strehëz, dhe po mbështet plotësimin e dokumentacionit për viktimat e trafikimit që mund të përfitojnë ndihmën ekonomike.



ORGANIZATA
TË NDRYSHËM & TË BARABARTË



MIRA¹: NJË HISTORI MBIJETESE

Mira pati një fejesë të madhe me shume të ftuar, nga të dyja familjet.

Pas një farë kohe, ajo dhe i “fejuari” i saj, vendosin të largohen nga Shqipëria, në një nga shtetet e Bashkimit Europian, ku do të kishin një jetë më të mirë. Por shumë shpejt, “i fejuari” e detyron me dhunë dhe me kërcënime nga më të ndryshmet, për të prostituar. E frikësuar për familjen e saj dhe e gjetur pa asnjë mbështetje, Mira i nënshtrohet fatit. Kalvari i vuajtjeve ishte i pafund. Cdo ditë trafikanti do të gjente një arsye për ta keqtrajtuar dhe për ti kujtuar se ajo i përkiste atij.

Një ditë kur Mira ishte lënë vetëm, ajo merr guximin për të shkuar në polici. Aty kerkon ndihmë dhe denoncon trafikantin e bashkëpuntorët e tij. “Ende sot nuk e kuptoj ku e gjeta forcën për të bërë atë veprim- shprehet ajo- kur unë, në fakt, dridhesha vetëm kur dëgjoja zërin e tij në telefon.”

Pas kthimit në Shqipëri, ajo kerkon ndihmë pranë organizates sonë, për t’u asistuar me shërbime ri-integruese.

Si pasojë e trafikimit, Mira kishte probleme të shumta emocionale, psikologjike e shëndetësore, duke shfaqur herë pas herë edhe shenja depresioni. Ky do të ishte edhe objektivi i parë i planit të ndihmës së ofruar për të, nga ekipi shume disiplinësh i organizatës, pra stabilizimi i gjendjes së saj psikologjike dhe shëndetësore. Me ndërmjetësimin e D&E, ajo do të rindërtonte gradualisht marrëdhëniet me anëtarët e familjes, të cilat, pothuajse ishin shkëputur gjatë periudhës së trafikimit.

Mira donte të ishte e zonja t’ia dilte vetë dhe të jetonte në mënyrë të pavarur: D&E e ndihmoi atë të ndiqte një kurs profesional dhe më tej, e mbështeti për të hapur një biznes të vogël, të cilin ajo vazhdon ende ta menaxhojë me sukses.

Sot është krenare për veten dhe për gjithçka që ka arritur të bëjë.

¹ “Ky nuk është emri i vërtetë”.



1. KË NDIHMOJMË NE?

PËRFITUESET E PROGRAMIT

Gati 90 % të përfitueseve të asistuar në program janë vajza dhe gra viktime të trafikimit dhe viktime të mundshme trafikimi. Më pak se 10% e rasteve të asistuar kanë qënë viktime të dhunës në familje dhe abuzimit. Të gjitha rastet kanë qënë të dhunuara nga bashkëshortët të cilët dhe i kanë denoncuar në Polici. Në bazë të ligjit nr. 9669 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”, për këto raste është dhënë me vendim gjykatë Urdhri i Menjëhershëm i Mbrojtjes.

Kategori	Nr. total i rasteve në program gjatë Janar-Dhjetor 2010	Nr i rasteve te mbar-tura nga Dhjetor 2009	Nr. i rasteve të reja në program gjatë Janar - Dhjetor 2010
Viktima trafikimi	54	26	28
Viktima të mundshme trafikimi	20	8	12
Fëmijë të shoqëruar me nënat e tyre	28	17	11
Viktima të dhunës dhe abuzimit	7	3	4
Totali	109	54	55

PROFILI I VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT

Profili i viktimave të trafikimit ndryshon nga viti në vit por në disa aspekte mbetet po ai, sidomos kur bëhet fjalë për kushtet ekonomike të familjeve të tyre dhe problemeve të tjera sociale të krijuara.



IDENTIFIKIMI DHE REFERIMI

Deri në muajin Nëntor 2010, identifikimi dhe referimi i viktimave të trafikimit, është bërë bazuar në udhëzimet e Mekanizmit Kombëtar të Referimit dhe janë referuar tek D&E për ndihmë viktimave të trafikimit, viktimave të mundshme ose persona në rrezik trafikimi.

Në muajin nëntor të vitit 2010 u krijuan “Procedurat Standarte të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Personave të Trafikuar”. Bazuar në këto procedura është bërë identifikimi dhe janë referuar tek D&E viktimave të mundshme si dhe viktimave të trafikimit.

Gjatë këtij viti 44 përfituese dhe 11 fëmijë të tyre janë referuar në program.

Rastet e referuara tek D&E sipas muajve në 2010

Muaji	Nr i rasteve të referuara	Nr i fëmijëve
Janar	0	0
Shkurt	2	1
Mars	3	1
Prill	6	3
Maj	7	0
Qershor	2	0
Korrik	4	2
Gusht	3	0
Shtator	6	1
Tetor	6	1
Nëntor	4	1
Dhjetor	1	1
Totali	44	11

BURIMET E REFERIMIT PËR RASTET E REJA TË REFRUARA PËR NDIHMË NË 2010

ORGANIZATA
TË NDRYSHËM & TË BARABARTË



Burimet e referimeve	Nr i Rasteve
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë (AP)	3
Drejtoria e Policisë, Tiranë	3
Drejtoria e Policisë, Durrës	3
Drejtoria e Policisë, Korçë	1
Drejtoria e Policisë, Burrel	1
Komisariati i Policisë së Rinasit	1
Prokuroria e Krimeve të Rënda	3
MPÇSSHB, Autoriteti Përgjegjës	1
Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit	7
Shoqata “Tjetër Vizion”	3
Qendra psiko-sociale “Vatra”	1
Zyra Rajonale e Shërbimit Social Tirane	2
Qendra Sociale në ndihmë të fëmijëve dhe grave në nevojë (Bashkia Tiranë)	1
Qendra për Nisma Ligjore Qytetare	2
Shoqata Kristiane e të Burgosurve Shqiptarë	1
Strehëza e vajzave dhe grave të dhunuara	1
Institucioni i fëmijëve “Fillimet e Reja”, Tiranë	1
Qendra e Këshillimit të Grave dhe Vajzave të Dhunuara (Forumi i Gruas), Elbasan	1
Terre des Homme / CPU Sarandë	2
Shoqata “Në dobi të gruas”	2
Kisha Baptiste	1
Kongregata “Motra Kanosiane”, Shën Vlash	1
Motrat e Nënë Terezës	1
Vetëreferuar	1
TOTAL	44

Siç vihet re në tabelë, 27% e rasteve janë referuar nga struktura të Policisë e kryesisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Drejtoritë e Policive nëpër rrethe të ndryshme (Tiranë, Durrës, Korçë, Burrel) dhe Komisarati i Policisë Rinas;

14 % nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, MPÇSSHB (Autoriteti Përgjegjës) dhe Zyra Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror; 25% nga qendrat anëtare të Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Antitrafik (QKPVT, qendra psiko-sociale “Vatra” në Vlorë dhe shoqata “Tjetër Vizion” në Elbasan); 2% nga Qendra Sociale, pjesë e Bashkisë së Tiranës; 23% e rasteve janë referuar nga shoqata dhe strehëza të tjera të cilat ofrojnë shërbime të ndryshme për grupe të caktuara në nevojë; 7% e rasteve janë referuar nga institucione fetare dhe vetëm 2% e tyre është vetëreferuar.



VENDET NGA TË CILAT VIJNË RASTET E REFERUARA

Duke iu referuar tabelës, 46% e rasteve të referuara vijnë nga zonat veriore të vendit. Rreth 34% e rasteve vijnë nga Shqipëria e Mesme dhe 18 % e rasteve vijnë nga zona jugore e vendit. Vetëm 1 rast gjatë vitit 2010 ka qënë nga Kosova.

Një përqindje e rasteve vijnë nga zonat urbane apo rurale, 52% e rasteve vijnë nga zona rurale dhe 48% e tyre nga zona urbane.

Ashtu sikurse dhe në vitin e kaluar vihet re një lëvizje shumë e madhe e familjeve të përfitueseve të programit nga zonat malore për tu vendosur në periferi apo zona informale pranë qyteteve të Tiranës e Durrësit. Kështu, 30% e rasteve të reja të hyra në program janë shpërngulur bashkë me familjen e origjinës nga veriu apo jugu i Shqipërisë dhe banojnë në zona informale apo periferi të qytetit të Tiranës e Durrësit.


Prej të cilëve, 21% e këtyre rasteve janë shpërngulur nga qytete e fshatra në veri të Shqipërisë aty ku kanë patur vendlindjen (Kukës, Tropojë, Dibër, Pukë) për të ardhur në Tiranë ose Durrës. Vetëm një rast është shpërngulur bashkë me familjen nga Peshkopia në një fshat të Krujës. Ndërsa 7% e rasteve të reja janë shpërngulur me familjen nga zonat jugore, juglindore si Lushnjë, Pogradec e Korçë, për të banuar më pas në Tiranë.

Qyteti	Nr i rasteve	Rurale	Urbane
Tropojë	1	1	
Kukës	3	3	
Pukë	2	1	1
Dibër	6	6	
Shkodër	6	1	5
Lezhë	2	1	1
Tiranë	7	1	6
Elbasan	5	1	4
Rrogozhinë	1		1
Durrës	2	1	1
Fier	1	1	
Lushnjë	1	1	
Berat	1	1	
Skrapar	1		1
Tepelenë	1	1	
Sarandë	1	1	
Pogradec	1	1	
Korçë	1	1	
Kosove	1		1
Total	44	23	21
Përqindje	100	52	48

¹ "Të Ndryshëm & Të Barabartë" 2009, Raporti Vjetor: Tiranë



VENDET NGA TË CILAT VIJNË RASTET E REFERUARA



Tropojë

Kukës

Pukë

Dibër

Shkodër

Lezhë

Tiranë

Elbasan

Rrogozhinë

Durrës

Fier

Lushnje

Berat

Skrapar

Tepelenë

Sarandë

Pogradec

Korçë



MOSHA E PËRFITUESEVE

Një përqindje e konsiderueshme e rasteve të hyra në program gjatë këtij viti janë minorene. Kjo tregon se historia e trafikimit dhe shfrytëzimit ka ndodhur në një moshë akoma më të vogël. Shumë nga përfitueset që kanë hyrë në program rreth moshës 19-25 vjeç janë trafikuar në moshë fare të re.

Gati 50% e rasteve të hyra në program mbi moshën 19 vjeç kanë qënë trafikuar e shfrytëzuar në moshë minorene por edhe të tjerat kanë përjetuar eksperiencën e shfrytëzimit sapo kanë mbushur 18 apo 19 vjeç. Vajzat minorene


vazhdojnë të mbeten preja e trafikantëve, duke ditur se ato shpesh përjetojnë ndryshime emocionale, psikologjike dhe fizike, pasi janë në kërkim të identitetit dhe pavarësisë së tyre.

Historitë e trafikimit të përfitueseve të ndihmës së D&E tregojnë se minorenat bien pre e trafikimit, jo vetëm si pasojë e konfuzionit apo krizës, përmes të cilës kalojnë, por edhe për shkak të problemeve familjare. Një ndikim të fuqishëm në këtë stad të jetës, ka edhe grupi social. Të gjendura pa mbështetjen e familjes dhe përballë një konfuzioni psikologjik dhe emocional, ato tentojnë të gjejnë përkrahje në burime, që shpesh përkeqësojnë situatën në të cilën gjenden. Një shpëtim për situatën e rënduar, është parë jo rrallë edhe arratisja nga familja me dikë, i cili është konsideruar si “i dashuri”. Ato kanë ndijesinë se janë mjaftushëm të rritura sa mund të marrin vendime vetë, por realisht kanë nevojë për familjen, për prindërit a te afërmit si këshillues e kujdestarë, mbështetja e të cilëve në të shumtën e rasteve mungon.

GRUPMOSHA E RASTEVE TË REJA

Grupmosha	14-17	18-25	26-30	31-35	36+	Totali
Nr i rasteve	11	23	6	1	3	44
Përqindja	25%	52%	14%	2%	7%	100%

Grupmosha e rasteve të reja





Mosha kur perfitueset kanë qënë trafikuar

Grupmosha	12-15	16-18	19-21	22-24
Nr i rasteve	7	14	11	8

KONTEKSTI FAMILJAR

Marrëdhëniet mes anëtarëve të familjes

Viktimat e trafikimit dhe ato në rrezik trafikimi vijnë nga kontekste të ndryshme familjare. Konteksti familjar duket të jetë një nga ndikuesit e drejtëpërdrejtë në vulnerabilitetin ndaj trafikimit. Historitë e familjeve të përfitueseve të D&E tregojnë faktorët që kanë lidhje shkakësore në trafikimin e tyre.

Marxhinalizimi i familjeve të ardhura/ të migruara

Lëvizjet e familjeve të përmendura më lart, janë gjithashtu domethënëse. Me gjithë shpërnguljet e familjeve të rasteve të referuara në program në zonat më tepër të zhvilluara si Tirana e Durrësi, mentaliteti tradicional vazhdon të mbizotërojë si martesë e vajzave të tyre në moshë shumë të re dhe shqetësimi më shumë se ç'duhet për thashethemet e gjykimet e fqinjëve dhe e komunitetit ku jetojnë.

Kjo krijon probleme në familje, sepse fëmijët janë më të hapur ndaj eksperiencave dhe mentaliteteve të reja, që janë të ndryshme nga ato të prindërve.

Problemi fillon kur prindërit kërkojnë bashkëshortë për vajzat e tyre dhe ato, për ti shpëtuar situatave ku gjenden, largohen nga familja. Rezultati final është mashtrimi dhe premtime falso për martesë, që përfundojnë me shfrytëzim dhe abuzim.

Situata ekonomike

Nëse ndalemi në rastet, vëmë re se 40% e tyre vijnë nga familje me status të ulët ekonomik. Stabiliteti dhe përkujdesi emocional ka një rëndësi të veçantë në marrëdhënien mes anëtarëve të familjes, bëhet gati i pamundur në raste vështirësish. Pamundësia për të plotësuar nevojat bazë të familjes si ushqimi, streha, të ardhurat minimale bëjnë që familja të gjendet përballë vështirësive të cilat mund të limitojnë kujdesin prindëror.

Familjet ndikuar nga statusi i ulët ekonomik, probleme me alkoolin, dhuna e ushtruar në familje, mungesa e njërit nga prindërit, rikompozimi i familjeve/rimartesat e prindërve dhe marrëdhëniet jo të mira me personin e ri që bëhet pjesë e familjes (njerku apo njerka) dhe incesti, mund të çojnë në një situatë familjare e cila në bazë ka neglizhimin e anëtarëve dhe nevojave të fëmijëve. Në këtë mënyrë problemet në mjedisin ku individi ka jetuar janë bërë shkak për lindjen e problemeve psikologjike dhe përballimin e tyre në mënyra joefektive.




Abuzimi nga një i afërm

Disa nga përfitueset janë braktisur që në lindje dhe nuk kanë jetuar kurrë me prindërit biologjik. Këto vajza ose kanë jetuar më gjyshërit ose me të afërm të tjerë dhe kanë jetuar aty deri në arratisje si pasojë e marrëdhënieve jo të mira mes anëtarëve, ngacmimeve seksuale, inçesteve dhe dhunës së ushtruar nga gjyshërit apo vëllezërit. Katër përfituese kanë qënë viktime inçesti.

Të tjera përfituese vijnë nga familje të rikompozuar të cilat nisin me braktisje nga njëri prind dhe jetesa me njerkun/ njerken në një marrëdhënie të trazuar. Kështu, 21% e rasteve vijnë nga familje ku njëri nga prindërit ka vdekur; 14% e rasteve kanë qënë braktisur nga njëri prej prindërve dhe 14% e rasteve kanë jetuar me njerken apo njerkun.

Ndryshimet mes brezave në familje

Konfliktet familjare iniciuar nga mentalitete të ndryshme, diferencat në të menduar mes gjeneratave, kanë evoluar deri në vendimin për t'u larguar nga familja. Traumata e familjes në të cilën janë rritur janë të dukshme tek rasti i secilës vajzë. Karakteristika të tilla si agresiviteti, ankthi, varësia, të qëniti mosbesuese dhe me imazh të ulët për veten, janë tregues të mundshëm të traumave që mund t'i atribuohen kontekstit familjar.





NIVELI ARSIMOR I VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT

52% e rasteve kanë përfunduar arsimin e detyruar 8-9 vjeçar ndërsa rreth 20% nuk e kanë përfunduar arsimin 8-9 vjeçar apo nuk kanë kryer asnjë klasë shkollë. Rastet e tjera: 4.5% kanë përfunduar shkollën e mesme; 16.5% e rasteve kanë ndjekur një vit ose dy vjet nga shkolla e mesme duke mos e përfunduar atë; 2% (vetëm 1 rast) ka përfunduar arsimin e lartë dhe 4.5% e rasteve nuk e kanë përfunduar arsimin e lartë. Tre raste nuk kanë kryer asnjë klasë shkollë dhe 13,5% e rasteve nuk kanë përfunduar arsimin 8-9 vjeçar. Rastet të cilat nuk kanë kryer asnjë klasë shkollë janë raste të cilat janë vlerësuar edhe nga mjekja psikiatre e organizatës me prapambetje të lehtë mendore apo çrregullime të tjera mendore. Përveç problemeve të tyre lidhur me shëndetin mendor, mosndjekja e shkollës ka qënë edhe si pasojë e moskëmbënguljes së familjes apo stigmatizimit nga rrethi shoqëror si pasojë e prapambetjes.

Niveli i informimit të përfitueseve

Shumica e përfituesve nuk kanë pasur asnjë lloj informacioni për trafikimin ose fenomene të ngjashme. Përfitueset që kishin dëgjuar më parë për trafikimin nuk i njihnin mjetet e duhura për të mbrojtur veten ose strukturat ku mund të kërkonin ndihmë.

2. TRENDET E TRAFIKIMIT DHE TË SHFRYTËZIMIT

Mënyrat e rekrutimit

15 viktima trafikimi apo viktima të mundshme trafikimi janë rekrutuar duke iu ofruar premtim për martesë. Kryesisht këto premtime janë bërë nga personat që konsideroheshin nga vajzat si të dashurit e tyre, persona të cilët janë dhe iniciuesit e futjes së tyre në trafikim. 9 përfituese janë rekrutuar duke ofruar premtim të rremë për punë kryesisht nga persona të afërt si shokë, shoqe e fqinj të lagjes, ku ato banonin.

Arsimi	Nr i rasteve	Përqindja
Pa arsim	3	7 %
8-9 vjeçare	23	52 %
8-9 vjeçare e papërfunduar	6	13.5 %
E mesme e papërfunduar	7	16.5 %
E mesme e përfunduar	2	4.5 %
I lartë i përfunduar	1	2 %
I lartë i papërfunduar	2	4.5 %
Total	44	100 %



Tre përfituese janë rrëmbyer kryesisht nga vendi tyre i punës apo nga shkolla. Tre përfitueseve të tjera iu është ofruar martesë. Ato janë gjendur në rrethana jo të lehta për të bërë punë të detyruar si rritjen e fëmijëve që bashkëshorti ka patur nga martesë të mëparshme, punimi i tokës, etj. Këto martesë kanë qënë të gjitha martesë pa celebrim. Disa përfitueseve ju është ofruar premtim për strehim, ushqim dhe mbrojtje nga shokët apo shoqet pas largimit nga familjet e tyre. Këto janë edhe mashtrimet klasike, të cilat janë tepër të besueshme nga vajzat, sidomos pas largimit nga shtëpia, si pasojë e problemeve në këtë ambient e të qenit në mes të rrugëve pa patur strehim tjetër.

Premtim falso për punë:

M. është nga një qytet i vogël i Shqipërisë. Ajo nuk u lejua nga familja të ndiqte shkollën e mesme. Disa persona, nga i njëjti qytet i premtuan ta ndihmonin të largohej nga Shqipëria, të gjente një punë dhe të jetonte në mënyrë të pavarur. Asaj ju premtua një punë dhe u shfrytëzua për prostitucion në vendin fqinj.

Premtim falso për martesë si mënyrë rekrutimi


Pas largimit nga shtëpia, Q. njihet me një djalë me të cilin bashkëjeton për vite me rradhë, bashkëjetesë nga e cila lindin dhe fëmijë. Kjo bashkëjetesë nuk u bë asnjëherë martesë e ligjshme. Përveç kësaj, që në vitin e parë të bashkëjetesës, Q. nxirret në rrugë për të lypur, dhe paratë e fituara administrohen vetëm nga bashkëjetuesi.

Premtim i rremë për strehim e mbrojtje

Xh. vjen nga një qytet i Shqipërisë së Mesme. Pas largimit nga shtëpia një i panjohur i ofron mbështetje: strehim, ushqim e mbrojtje, por qëllimi i tij i vërtetë ishte që ta shfrytëzonte për qëllime prostitucioni. Kështu ajo shfrytëzohet në disa qytete në jug të Shqipërisë në ambiente të ndryshme të hoteleve.

Rrëmbim

Nisur nga vështirësitë financiare në familje, S. nga qyteti M. filloi punë në një dyqan. Pasi punoi pak kohë ajo u rrëmbye nga pronarët e dyqanit. Ata e çuan në një shtëpi ku e shfrytëzuan së bashku me vajza të tjera, të cilat po ashtu shfrytëzoheshin.



- Premtim falso për martesë
- Premtim false për akomodim dhe mbrojtje
- Rrembim
- Martesë
- Premtim falso për punë



MËNYRAT E PËRDORURA NGA SHFRYTËZUESIT PËR TË KONTROLLUAR VIKTIMAT

Metodat e përdorura nga trafikantët për të detyruar vajzat të prostituojnë kanë qënë kryesisht dhunë fizike, emocionale dhe psikologjike. Trafikantët kanë përdorur abuzimin seksual, përdhunimin, kërcënimet ndaj tyre dhe familjeve si taktika të zakonshme. Një tjetër taktikë e zakonshme për ti mbajtur në kontroll është dhënia e substancave dhe drogave të ndryshme. Pothujase, në të gjitha rastet, vajzat janë mbajtur të mbyllura dhe nën kontrollin total të trafikantëve.

Trafikantët kryesisht kanë zgjedhur rrugët tokësore për të transportuar viktimat e trafikimit në destinacionin e tyre final. Vendet jashtë Shqipërisë, në të cilat ato janë shfrytëzuar kanë qënë: Kosovë, Greqi, Itali

Itineraritet kryesore për të shkuar në destinacion ka qënë:

Tiranë-Kukës-Prishtinë (Kosovë)
Tepelenë-Fier-Korcë-Athinë (Greqi)
Tiranë-Shkodër-Mali i Zi-Kroaci-Slloveni-Itali

Rastet të cilat janë shfrytëzuar në Shqipëri kryesisht kanë qënë të shfrytëzuara në shtëpi banimi, vila, hotele e motele në periferi të qyteteve apo të lagjeve të vogla. Qytetet kryesore ku janë shfrytëzuar kanë qënë: Tiranë, Durrës, Korçë, Lezhë, Fier, Vlorë dhe Sarandë.

Itinerari i ndjekur ka qënë:

Kavajë-Tiranë-Korçë
Tiranë-Durrës
Elbasan-Durrës
Tiranë-Vlorë / Vlorë-Tiranë-Durrës
Tepelenë-Fier
Lezhë-Tiranë


Format e abuzimet

M. përpigëj të bënte rezistencë ndaj shfrytëzuesve për të refuzuar klientët. Për këtë ajo keqtrajtohej, rrihej e goditej me mjete të forta duke i injektuar gjithashtu dhe drogë. Si pasojë e kësaj S. vuajti nga çrregullime të stresit post traumatik dhe iu desh kohë të përmirësohej dhe të stabilizohej nga gjëndja shëndetësore.

R. është trafikuar në Itali. Nga Tirana ajo është transportuar për në pikën kufitare të Hanit të Hotit. Pas kalimit në Malin e Zi, udhëtimi ka vijuar drejt Kroacisë, Sllovenisë për të përfunduar pastaj në Itali.



Vendet ku rastet janë trafikuar





Llojet e shfrytëzimit të rasteve të reja

Këtë vit ka pasur raste të referuara tek D&E të cilat janë shfrytëzuar për punë të detyruar dhe/ ose në martesë. Shfrytëzimi për punë ka ndodhur kryesisht për punë bujqësie, punë në lokale si kamariere e kërcimtare. Martesa e detyruar është një lloj tjetër shfrytëzimi i cili është bërë për një arsye specifike dhe është shoqëruar shpesh me punë të detyruar si për shembull për rritjen e fëmijëve të ardhur nga martesë të mëparshme, punimi i tokës etj. Këto martesë nuk kanë qënë kurrë të ligjshme. Në shtatë raste të reja ka ndodhur më shumë se një formë shfrytëzimi. Disa prej tyre janë detyruar të bëjnë shpërndarje droge. Ne i referohemi këtij lloji shfrytëzimi si veprime të ulta kriminale.

Nivel i ulët i akteve kriminale

S. shfrytëzohej seksualisht në hotele e motele. Përveç kësaj shfrytëzuesi e përdorte dhe për të shpërndarë drogë duke qënë kështu vetë më pak i ekspozuar ndaj njerëzve dhe për më tepër ndaj policisë. S. ishte e detyruar ta bënte duke qënë e shoqëruar apo e vëzhguar gjatë gjithë kohës nga tutori.

Martesë e detyruar

Prindërit e K. ushtronin gjithnjë e më shumë presion duke i kërkuar asaj të martohej pasi i kishte kaluar mosha, megjithëse ajo ishte shumë e re. Një i afërmi i saj i gjen një burrë nga i cili merr edhe një pagesë. Ata nuk bënë asnjëherë martesë të ligjshme e për më tepër qëllimi i tij ishte ta shfrytëzonte K. për të mbajtur shtëpinë e gjithashtu për të rritur fëmijën që kishte nga një lidhje tjetër, ndërkohë që ai vetë nuk punonte e për më tepër ishte përdorues droge e alkooli.

Shfrytëzim për punë

L. vjen nga një familje problematike. Ajo humb njërin prind ndërkohë që tjetri nuk ka qënë kurrë i pranishëm në jetën e saj. Ajo martohet dhe jeton me dikë (pa celebrim). Bashkëshorti i saj kishte një martesë paralele në një shtet tjetër dhe kalonte shumë kohë në emigrim. Ndërkohë L. jeton me prindërit e bashkëshortit dhe shfrytëzohet për punë e kryesisht bujqësi dhe blegtori.



Llojet e shfrytëzimit të rasteve të reja





3. ÇFARË BËJMË NE?

Projekti 1

OFRIMI I ASISTENCËS RI-INTEGUESE TË QËNDRUESHME PËR ISH-VIKTIMAT SHQIPTARE TË TRAFIKIMIT

Peridha: Janar - Dhjetor 2010

Donatorë : USAID/IOM

KBF- King Boudouin Foundation-Belgjikë

Ministria e Jashtme e Norvegjisë

Vodafone Foundation Albania

UN.GIFT/UNODC – Iniciativa Globale e Kombeve të Bashkuara në luftën kundër trafikimit

UN.OHCHR - Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut e Kombeve të Bashkuara

SRTV Holandë – Fondacioni Fetar Hollandez kundër trafikimit

MIVA Holand

Qëllimi i këtij projekti është të ofrojë një paketë të plotë shërbimesh ri-integruese për ish viktimat shqiptare të trafikimit dhe për fëmijët e tyre duke i ndihmuar ato të rimarrin veten nga abuzimet e përjetuara.

Gjatë vitit 2010 janë ndihmuar në programin e organizatës gjithsej 109 përfitues nga të cilët 81 vajza dhe gra dhe 28 fëmijë të tyre, D&E ju ka ofruar një paketë të plotë shërbimesh për rehabilitimin, fuqizimin dhe ri-integrimin e tyre në shoqëri.

Të gjitha rastet e reja kanë hyrë në program vullnetarisht dhe secilit prej rasteve u është caktuar një menaxher i rastit / punonjëse sociale. Ekipi MULTIDISCIPLINAR i D&E që përfshin punonjësen sociale të çdo rasti, psikologjen, mësuesen, doktoreshën dhe avokaten, kanë bërë vlerësimet e nevojave të tyre bazuar në format e vlerësimit të standarteve të aprovuara nga MPÇSSH. Pas vlerësimit të nevojave, menaxherja e rastit bashkë me përfituesen kanë ndërtuar planin e asistencës bazuar në objektiva të përgjithshëm dhe specifike.

Aktivitetet rehabilituese – riintegruese sipas planit individual të asistencës zhvillohen në tre faza dhe përfshijnë shërbime të ndryshme si:

Këshillim, Shërbime mjekësore, Ndërmjetësim me familjen, Asistencë Ligjore, Ndihmë për Fëmijët e Përfitueseve, Trainime për rritjen e aftësive për jetën, Trainime për punësim, Shkollim, Aktivitete Sociale, Gjenerim të ardhurash.



TRE FAZAT

Procesi i Ri-integrimit

Faza 1: Ndërhyrja në situatë krize (Akomodimi)

Në fazën e parë të programit, përfitueset janë të akomoduar në strehëzën e D&E, e cila ndodhet në një vend sekret, të sigurtë dhe me mbrojtje të plotë sigurie.

Në këtë fazë, përfitueseve ju ofrohen një sërë shërbimesh si: ekzaminime dhe trajtim mjekësor; Këshillim psiko-social; Mbështetje dhe asistencë ligjore; Negocim/ndërmjetësim me familjen kur rastet duan të rivendosin marrëdhënie të shëndetshme me familjen e tyre; Kujdes ditor për fëmijët e viktimave të trafikimit; Kurse/trajtime profesionale; Përgatitje për vazhdimin e shkollimit; Mësim shkrimi e leximi; Këshillime dhe ndihmë për punësim; Aktivitete për përmirësimin e aftësive vetjake; Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive etj.

Faza 2 & 3: Tranzicioni në jetën e pavarur

Në fazën e dytë të programit, përfitueset fillojnë të hedhin hapat drejt pavarësisë dhe ri-integrimit të plotë në shoqëri. Pavarësia e plotë arrihet në fazën e tretë të programit. Këtë vit, 26 përfituese janë asistuar në fazën e dytë të programit. 32 përfituese kanë kaluar në fazën e tretë, në jetesën e pavarur. Tani ato kanë një punë të qëndrueshme ose punojnë në biznesin e tyre; vazhdojnë ose kanë mbaruar shkollën; disa prej tyre janë fejuar dhe më pas janë martuar; apo jetojnë me familjet e tyre të origjinës. Të gjitha janë shumë të interesuara që të vazhdojnë të jenë në kontakt me stafin e D&E.

Gjatë këtij viti, 11 përfituese kanë kaluar në fazën e dytë të programit duke jetuar në apartamente me qera dhe 12 të tjera janë kthyer në familje duke vazhduar mbështetjen dhe duke i monitoruar e ndjekur vazhdimisht si dhe nje prej tyre, ka kaluar nga familja në apartament, duke qënë se marrëdhëniet midis saj dhe familjes u përkeqësuan. Pesë përfituese të reja kanë hyrë direkt në fazën e dytë të programit dhe 4 të tjera janë ndihmuar direkt në familje.

D&E ka mbështetur përfitueset në fazën e dytë e të tretë të programit me: seanca këshillimi; shërbime mjekësore për to dhe fëmijët e tyre (analiza, vizita mjekësore dhe blerje të medikamenteve); kurse profesionale të avancuara; mundësi punësimi; mbështetje financiare për pagesën e qerasë së apartamentit si dhe pagesa e çerdhes apo kopështit të fëmijëve të tyre, dhënie e informacionit lidhur me shërbimet që ofrohen në komunitet, etj. Kështu, 25 raste janë mbështetur financiarisht për pagesën e qerasë së apartamentit.

D&E ka bashkëpunuar me SHKBSH (Shoqatën Kristiane të të Burgosurve Shqiptarë) në mbështetjen financiare të disa prej përfitueseve në fazën e dytë të programit për pagesën e qerasë së apartamentit dhe shpenzime të tjera të nevojshme. Një bashkëpunim i tillë ka qënë dhe me Motrat e Nënë Terezës të cilat po ashtu kanë mbështetur financiarisht për pak muaj disa prej përfitueseve të programit të D&E.



MONITORIMI DHE NDJEKJA E RASTEVE

Një nga elementët kryesorë të ndihmës në fazën e dytë dhe të tretë të programit është monitorimi i rasteve. D&E ju kushton përfitueseve në këto dy faza të programit vëmendje të veçantë duke qënë se nevojat e tyre dhe sfidat që ju duhet të përballojnë për t'u riintegruar në shoqëri janë të shumta. Monitorimi i përfitueseve realizohet kryesisht me anë të takimeve direkte, si në ambjentet e zyrave të D&E, ashtu edhe në qytetet ku përfitueset janë duke u ri-integruar. Kjo bëhet edhe me anë të kontakteve me telefon në mënyrë periodike sipas planit të monitorimit.

Procesi i monitorimit është fokusuar kryesisht mbi shëndetin e përfitueseve, situatën e punësimit, kërkesat për rritje profesionale nëpërmjet kurseve më të avancuara, arsimimi, ecuria e marrëdhënieve me familjen, marrëdhëniet ndërpersonale, asistenca ligjore, nevojat për këshillim psiko – social, probleme sigurie, menaxhimi i aktiviteteve ditore dhe të ardhurave, etj.

Deri në fund të vitit 2010, 33 përfituese janë monitoruar në apartamente dhe 24 përfituese janë asistuar dhe mbështetur në familje. Ka pasur edhe dy raste me probleme të shëndetit mendor, të cilat janë monitoruar gjatë qëndrimit në institucione të tjera (Motrat e Nënë Terezës dhe Madonnina Del Grappa).

Gjatë këtij viti 38 përfituese janë fuqizuar dhe jetojnë në mënyrë të pavarur dhe 29 të tjera janë në proces ri-integrimit.

Përveç rasteve të asistuara në dy fazat e programit si dhe rasteve të fuqizuara e të ri-integruara gjatë këtij viti, ka edhe të tjera, të cilat kanë qënë përfituese të programit vite më parë, që kërkojnë herë pas here të takohen me punonjëset e tyre e të mbajnë kontakte me organizatën. Numri i këtyre rasteve me të cilat është mbajtur kontakt gjatë vitit 2010 shkon në 58 dhe kontaktet përqëndrohen kryesisht në arritjet e deritanishme, marrëdhëniet me familjen, punësimi, shëndeti, probleme të hasura gjatë kësaj periudhe etj.

KËSHILLIMI PSIKO-SOCIAL

Gjatë vitit 2010 janë ofruar 3916 seanca këshillimi. Këshillimi psiko-social është fokusuar në:

- *Rivendosjen e kontrollit*
- *Rindërtimin e besimit tek vetja/ të kuptuarit se çka ndodhur*
- *Rritjen e vetëvlerësimit*
- *Rritjen e aftësive për të vendosur e mbajtur marrëdhënie pozitive mbështetëse*
- *Menaxhimin e stresit*

Rivendosja e kontrollit

Trafikimi, sidomos ai me qëllim shfrytëzimin seksual, por jo vetëm, ka pasoja të rënda të cilat fillojnë nga ato shëndetësore e vazhdojnë deri tek ato psikologjike e sociale. Të gjitha këto lidhen me përvojat e shfrytëzimit dhe të shfrytëzuesit. Mbi vajzat, viktima të trafikimit, përdoren tortura nga më ç'njerëzoret si kërcënime me jetë, përdhunime, plagosje, dhunë fizike, dhunë psikologjike, detyrim për bindje e deri tek privimi nga nevojat bazë, siç është të ushqyerit.



Një vajzë, viktimë trafikimi e strehuar në qendër, rrëfen:

“ Më kanë lënë dy ditë pa ngrënë, më kanë rrahur dhe torturuar në mënyra nga më ç’njerëzoret. Shenjat që kam në trup më kujtojnë gjithçka nga ajo kohë”

Ky kontroll tërësor që vihet në jetën e vajzës nga dikush tjetër, i bën ato të pranojnë gjithçka. Në këto kushte, vajzat viktimat të trafikimit, kanë pak hapësira, për të mos thënë aspak, për të zgjedhur. Një nga synimet e asistencës psikologjike që ofrohet në Qendrën Ri-integruese, është njohja me nevojat, dëshirat dhe ndërgjegjësimi për to, pasuar më pas, nga fuqizimi në vendimmarrje.

Duke punuar me rastet e trajtuara, është konstatuar që viktimat, të kontrolluara nga trafikanti, për vite me radhë, heqin dorë nga kontrolli i jetës së tyre dhe vetes. Niveli i ulët i kontrollit që zotërojnë shpie në vetëvlerësim të ulët, tërheqje dhe shmangie nga vendimmarrja, pasivitet dhe deri në paaftësi për të ndryshuar situatën, në të cilën ndodhen. Të ndodhur përballë kësaj tabloje, të afërmit dhe të tjerët kritikojnë vajzat për mos angazhim për ndryshim duke mos kuptuar, që e gjithë sjellja e tyre është pasojë e traumës së shfrytëzimit.

Rindërtimi i besimit

Ndihma e parë psikologjike nis me vendosjen e besimit mes psikologut dhe përfitueses dhe me shkarkimin emocional të saj. Traumata e mbivendosura, frikërat personale bëjnë që vajzat viktimat të trafikimit ta kenë shumë të vështirë të besojnë tek të tjerët:

“Nëna më ka braktisur kur unë isha 2 vjeç. Kur s’më ka dashur ajo, nuk mund të pres të më duan të tjerët. Prandaj nuk dua t’ja di për askënd. Asnjë nuk ma do të mirën. Nuk besoj tek askush, për asgjë”

Një reagim tjetër, i cili vihet re tek vajzat viktimat të trafikimit, është ai i identifikimit me agresorin. Kur viktimat perceptojnë një rrezik të jashtëm, në pamundësi për t’u mbrojtur, vendos të identifikohet me burimin e rrezikut duke pranuar agresionin dhe cilësi të tjera të personalitetit të kërcënuesit. Në lidhje me këtë, shpesh viktimat e trafikimit rrëfejnë lidhjet speciale që kanë me personat që i kanë shfrytëzuar duke i konsideruar shpesh si “të dashur”.

Një përfituese që kishte denoncuar thekson:

“Ai është sjellë shumë mirë me mua. Jam në merak për atë që i ka ndodhur. E ndjej veten fajtoreshë për këtë që i kam bërë”



Disa nga shqetësimet më të zakonshme, që vihen re tek vajzat, viktima të trafikimit, përfshijnë:

*Mungesa e shpresës, Zemërim, Irritueshmëri;
Frikë dhe ankth, ndjenja izolimi dhe detashimi të vetes.*

*Agresion ndaj të tjerëve dhe vetëdëmtim;
Vështirësi në krijimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve ndërpersonale.*

*Shqetësime rreth vetes dhe të tjerëve;
Pesimizëm për të ardhmen ;
Shqetësime me gjumin;
Humbje motivimi.*

*Fleshback të ngjarjes, makthe në gjumë;
Dyshime dhe mosbesim tek të tjerët;
Shmangie e situatave të lidhura me traumën;
Mendime ndërhyrëse të traumës;
Vetëfajsimi.*

Shqetësimet e lartpërmendura përfshihen në planin e ndërhyrjes jo vetëm në këshillime individuale por edhe në terapi grupi. Sesionet e këshillimit psikologjik kryesisht kanë konsistuar në:

Krijimi i një marrëdhënie besimi
Eksplorimi i ngjarjeve traumatike në jetën e tyre dhe simptomat
Emërtimi dhe artikulimi i emocioneve
Kuptimi i aftësive sociale
Trajnimi i kompetencave sociale
Fuqizim për marrjen e vendimeve në të ardhmen
Stabilitet emocional me qëllim përgatitjen për fazën tjetër të programit
Pavarësinë
Rritje vetëvlerësimi/ vetëbesim

MENAXHIMI I STRESIT

Mësimi dhe praktikimi i teknikave të menaxhimit të stresit dhe relaksimit, provojnë se janë shumë të nevojshme për viktimat e trafikimit, sidomos në menaxhimin e stresit dhe situatave momentale të cilat shkaktojnë ankth të menjëhershëm. Një nga teknikat relaksuese që është përdorur me vajzat ka qënë “meditimi” me qëllim minimizimin e stresit, ankthit dhe për rritjen e qetësisë shpirtërore.



KUJDESI SHËNDETËSOR

Probleme shëndetësore

Vëmëndje dhe rëndësi e veçantë, i është kushtuar shëndetit fizik dhe psikologjik të përfitueseve të përfshira në program.

Ndihma për rehabilitimin e tyre fizik dhe psikologjik ka qënë shumë më komplekse se sa vënia e një diagnoze të saktë apo përshkrimi i ca barnave. Për të gjitha rastet e përfshira në programin e riintegritimit është bërë diagnostikim, trajtim, parandalim, mirëinformim dhe edukim shëndetësor i vazhdueshëm.

Ndër problemet madhore që evidentohen më shpesh janë problemet e shëndetit riprodhues. Kushtet jo higjienike të jetesës, raportet seksuale me shumë partnerë, marrëdhëniet seksuale të pambrojtura, fillimi i hershëm i raporteve seksuale kur ende aparati riprodhues nuk është maturuar për të përballuar natyrshëm një raport, abortet në moshë shumë të vogël, lindjet e shpeshta dhe sidomos të afërta në kohë me njëra-tjetrën, infeksionet gjinekologjike dhe sëmundjet seksualisht të transmetueshme të patrajuara dhe të kronicizuara janë ndër arsyet kryesore që çënojnë shpesh dhe në një afat të gjatë (jo rrallë gjithë jetën) shëndetin riprodhues të tyre.

D&E u ka ofruar dhe u ka dhënë vullnetarisht të gjitha rasteve të reja të përfshira në program, mundësinë e egzaminimeve laboratorike për të diagnostikuar sëmundjet seksualisht të transmetueshme apo edhe sëmundje të tjera gjinekologjike. Në 44 raste të reja të përfshira në program gjatë vitit 2010, janë egzaminuar me strisho vaginale 25 raste dhe nga këto kanë rezultuar pozitiv 11 raste me SST dhe kryesisht me Clamidia Trachomatis, Trichomonas vaginalis apo edhe me Gardenerela etj. Të gjitha rastet që kanë rezultuar me SST janë trajtuar dhe ndjekur rregullisht. Një tjetër shërbim shëndetësor që është ofruar për përfitueset është egzaminimi për HIV 1 & 2, Hepatit B, Hepatit C dhe Sifiliz. Këto egzaminime janë bërë pranë Institutit të Shëndetit Publik, sigurisht, mbështetur mbi baza vullnetare. Janë egzaminuar 14 raste dhe ka rezultuar pozitiv për Hepatit B. një rast që ka qënë bartës i HBs-Ag, ndërsa rastet të cilat kanë bërë testin e HIV/AIDS kanë rezultuar negativë.

Një kujdes dhe trajtim i veçantë është bërë për të gjitha rastet me probleme dentare duke ofruar sipas rastit mbushje të dhëmbëve kariozë, ekstraksione të dhëmbëve të dëmtuar deri edhe vendosje të protezave dentare. Kujdes është ushtruar që trajtimet dentare të kenë edhe pamje estetike më të mirë duke ndikuar kështu pozitivisht edhe në vetëvlerësimin e përfitueseve.



Probleme të diagnostikuara dhe trajtuara gjatë 2010

Diagnoza	Nr. i përfituesve
S. të aparatit urinar	4
S.Dermatologjike	5
Colica abdominal dhe renale	3
ORL	3
Hepatit B	1
S.Neurologjike	4
S. Alergjike	3
S. Gjinekologjike	11
S. Tokikologjike	3
Semundje Dentare	13
Haemorrhoidë	2
S.Gastro-intestinale	4
Raste të shtruara në spital	2
Inf. të aparatit respirator	4
Prob. Okulistike	6



Shëndeti Mendor

Një tjetër fushë në kujdesin shëndetësor është edhe ajo e shëndetit mendor. Kur është evidentuar nga ana e personelit mjekësor apo edhe pjesës tjetër të stafit, prania e shqetësimeve dhe problemeve të shëndetit mendor, rastet janë referuar tek mjekja psikiatre. Ato janë ndjekur me shumë rigorozitet duke kryer vizita të vazhdueshme kontrolli. Kështu, është bërë e mundur marrja e mjekimit të nevojshëm.

Probleme të shëndetit mendor

MÇrregullim/Sëmundje mendore	Numri i rasteve
Çrregullim ankthi	1
Çrregullime të stresit post traumatik	1
Çrregullim depresiv	2
Borderline	3
Çrregullim personaliteti	1
Çrregullime te sjelljes	2
Skizofreni	3
Prapambetje mendore	2
Epilepsi	1
Total	16



Asistencë për përfitueset shtatzëna

Kujdes i veçantë është treguar për tre raste shtatzanie që janë asistuar nga D&E. Janë bërë të gjitha përpjekjet që gjithçka të shkonte mirë si gjatë shtatzanisë dhe gjatë lindjes duke i shoqëruar vajzat në vizitat tek obstetri, për egzaminime laboratorike dhe ekografike që janë bërë me rregull sipas protokolleve të ndjekjes së gruas shtatzanë duke ndjekur me rigozitet hap pas hapi shtatzaninë. Përveç dietës së përshtatur për shtatzaninë ju është dhënë dhe suplement me acid folik apo dhe me multivitamina sipas rekomandimit të obstetër – gjinekologut.

U është dhënë suport emocional dhe psikologjik nga të gjitha punonjëset, pasi vetë shtatzania është një periudhë shumë delikate, e karakterizuar natyrshëm dhe nga paqëndrueshmëria emocionale që për arsye objektive në rastin e këtyre vajzave, ka qënë e amplifikuar.

Edukimi mjekësor

Pjesë e përpjekjeve për aftësimin dhe ri-integrimin e tyre në jetën sociale ka qënë dhe edukimi i vazhdueshëm mjekësor për probleme nga më të ndryshmet për të cilat kanë shfaqur interes ato vetë ose është parë nga ana e stafit me vlerë për t'u trajtuar.

Personeli mjekësor ka zhvilluar një larmi të madhe temash mbi shëndetin në formën e diskutimeve të përbashkëta duke synuar të edukohen tek përfitueset sjellje të shëndetshme dhe të ndërgjegjësohen për rreziqet që shoqërojnë disa sjellje.

Ja disa nga temat e trajtuara :

Çfarë janë SST dhe si të mbrohem nga to;

HIV/AIDS;

Shtatzaninë e padëshiruara dhe metodat e kontracepsionit;


Abortet dhe rreziqet e tyre;



Shtatzania dhe kujdesi gjatë saj;
Duhani, alkoli dhe drogat e tjera, rreziqet që ato bartin;
Kujdesi për fëmijët;
Higjena personale;
Gripi, si ta parandalojmë dhe si ta trajtojmë;
Dieta e shëndetshme;
Aktiviteti fizik dhe rëndësia e tij për të qënë të shëndetshëm;
Vaksinimi i fëmijëve dhe rëndësia e tyre;

Ushtrime fizike

D&E ka krijuar në strehëz një mini palestër që vajzat të ushtrohen disa herë në javë. Kësaj pjese i është dhënë rëndësi jo thjesht për një fizik të shëndetshëm por dhe si mundësi e shkarkimit të stresit dhe energjisë negative.





NDËRMJETËSIM ME FAMILJEN

Rivendosja e marrëdhënieve pozitive me familjen (me dëshirën e vetë përfitueseve) ka qënë dhe vazhdon të jetë një nga synimet e punës së organizatës sonë pasi konsiderojmë shumë të rëndësishme bashkëpunimin me familjen në lehtësimin e procesit të ri-integrimit të përfitueseve. Kemi konstatuar se vajzat, të cilat kanë marrëdhënie të mira dhe mbështetjen e familjes, janë të suksesshme dhe në ri-integrimin në shoqëri.

Në vitin 2010, për disa vajza dhe gra, të hyra në program, ka qënë e vështirë të vendosnin marrëdhëniet me familjet e tyre të origjinës që në kontaktin e parë. Roli i punonjësit social ka qënë shumë i rëndësishëm në rivendosjen e këtyre marrëdhënieve. Menaxherët e rasteve kanë organizuar seanca këshillimi jo vetëm për rastet e akomoduar në qendër por gjithashtu për prindërit e tyre, motrat e vëllezërit.

Gjatë vitit, 12 përfituese janë kthyer në familjet e tyre e vazhdojnë të mbështeten e të ndihmohen nga organizata edhe gjatë qëndrimit në familje.

Në qendrën e ri-integrimit, komunikimi me familjet e përfitueseve është realizuar nëpërmjet telefonatave të rregullta gjatë gjithë periudhës. Ato priten shumë mirë nga përfitueset dhe kënaqen kur komunikojnë së bashku. Përveç telefonatave, përfitueset kanë patur mundësinë të takohen me familjet e tyre edhe këtu në Tiranë. Takimet janë bërë në zyren e D&E ose në bar-kafe, për rastet që nuk kanë patur probleme sigurie, ndërsa për rastet me probleme të tilla, takimi është mundësuar në ambjentet e policisë. Qëllimi i këtyre takimeve është përmirësimi i marrëdhënieve përmes komunikimit të hapur.

ASISTENCA LIGJORE

Asistencë ligjore për çështjet penale

Për ofrimin e këtij shërbimi, D&E ka bashkëpunuar me Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare(QNLQ). Avokatja e kësaj qendre ka bërë vlerësimin ligjor për të gjitha përfitueset e reja të hyra në program gjatë këtij viti. Përveç vlerësimit ligjor, përfitueset janë informuar rreth të drejtave themelore të tyre e veçanërisht të drejtën për dëmshpërblim, bazuar në ligjin nr. 9265, datë 29.07.2004 “Për Ratifikimin e Konventës Europiane “Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme”.

24 përfituese të asistuar në programin e riintegrimit të D&E gjatë vitit 2010 kanë denoncuar trafikantët e tyre. 20 prej këtyre janë raste të reja të hyra në program gjatë këtij viti. Përveç bashkëpunimit me Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare, D&E ka bashkëpunuar dhe me Drejtoritë e Policive në rrethet ku përfitueset kanë bërë denoncimet, si



edhe me Prokurorinë e Krimeve të Rënda në mënyrë që ato të mbështeten në ndjekjen e proceseve, marrjen e informacionit lidhur me këto çështje dhe mbështetjen për sigurinë e tyre.

Pas përfundimit të procesit penal dhe dënimit të dhënë për trafikantët, dy përfituese kanë bërë dhe padi civile për dëmshpërblim bazuar në ligj. Një prej rasteve ka fituar edhe procesin civil për të drejtën e saj për kompensim. QNLQ është duke e mbështetur në ekzekutimin e vendimit të gjykatës për kompensimin. Përfituesja tjetër është akoma në proces.

Mbështetja për sigurimin e dokumentacionit ligjor

Të gjitha përfitueset janë mbështetur për t'u pajisur me dokumente identifikimi dhe janë shoqëruar në vendet e tyre të origjinës për të bërë aplikimin për kartë identiteti apo pasaportë. Kështu, 16 përfituese janë pajisur me mjete identifikimi në vendregjistrimet e tyre: Fier, Lezhë, Shkodër, Memaliaj, Fushë Krujë, Vlorë e Tiranë.

Mbështetje gjithashtu është siguruar për përfitueset të cilat kanë dëshiruar të shpërngulen, për regjistrimin e tyre në gjendje civile në Tiranë.

D&E ka bashkëpunuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjëndjes Civile për krijimin e lehtësirave në regjistrimin e fëmijëve të VeT në zyrat e gjëndjes civile.

ASISTENCA PËR FËMIJËT E PËRFITUESEVE

Gjatë këtij viti, në programin e D&E janë asistuar 28 fëmijë të përfitueseve, 10 prej tyre kanë qenë fëmijë të moshës (1 muajsh - 3 vjeç) dhe janë asistuar në Qendrën Riintegruese.

Kujdesi mjekësor

Të gjithë fëmijët janë regjistruar në konsultore dhe kanë bërë vaksinat e duhura sipas rekomandimit të pediatrit. Gjithashtu fëmijëve të porsalindur u është ofruar i gjithë kujdesi i nevojshëm për rritjen e tyre në mënyrë të shëndetshme.



Regjistrimi në çerdhe e kopësht

Gjatë këtij viti janë rregjistruar në çerdhe e kopësht 6 fëmijë për herë të parë dhe në total kanë frekuentuar çerdhen dhe kopështin 12 fëmijë. Fëmijët janë rregjistruar në çerdhen apo kopështin që ndodhet pranë vendbanimit të tyre dhe për ta është bërë dhe pagesa mujore sipas kuotave të vendosura nga shteti. Për rregjistrimin e tyre është përgatitur i gjithë dokumentacioni i duhur, dhe rastet të cilat kanë bërë shpërnguljen dhe janë rregjistruar në gjendje civile në Tiranë janë mbështetur për nxjerrjen e dokumentave të nevojshme me qëllim përfitimin e çerdhes apo kopështit pa pagesë në kuadër të programeve të Bashkisë së Tiranës.

Regjistrimi në gjendje civile dhe pajisja me çertifikata

Pesë fëmijë janë rregjistruar në gjendje civile në Tiranë: një e porsalindur; tre fëmijë të rregjistruar në Tiranë pas shpërnguljes bashkë me nënat e tyre dhe një fëmijë i lindur në Kosovë i rregjistruar në Tiranë pranë trungut familjar të nënës. Aktualisht janë duke u siguruar dokumentat edhe për një fëmijë tjetër, të lindur në Kosovë për t'u rregjistruar në gjendje civile bashkë me nënën.

Shikoni projektin 2 për mbështetje të tjera për fëmijët dhe nënat e tyre.

AKTIVITETE PËR RITJEN E AFTËSIVE PËR JETËN

Për rritjen e aftësive për jetën janë organizuar grupe pune të cilat përmes problemave dhe gjëagjësive argëtuese synojnë aftësimin në zgjidhjen e problemeve dhe kërkimin e rrugëve alternative në zgjidhjen e çështjeve të caktuara. Në aktivitete të caktuara si menaxhimi i parave, konvertimi i monedhave dhe njohja me to, të psonisurit, improvizimi i lojërave shitësi- blerësi, llogaritja e përqindjes dhe kthimi i shumave të caktuara në përqindje me qëllim fitimin e shkathtësive në aftësimin për jetën e përditshme dhe kërkesat që ajo parashton.

Janë organizuar gjithashtu diskutime në grup, drejtuar nga mësuesja në lidhje me tema të caktuar mësimore që lidhen me klimën, ngrohjen globale, dëmet e shkaktuara nga thatësira, ngritja e nivelit të ujit dhe përmytjet, e shumë fenomene të tjera natyrore. Diskutime të tilla përveçse kanë qëllim informimin, asimilimin më të mirë dhe një rrugë më të shpejtë të informacionit, synojnë gjithashtu argëtimin dhe të ndjerit i vlefshëm për të tjerët/ informacionin që ato transmetojnë në grup.

Në festa të ndryshme janë organizuar grupe diskutimi për historikun e festës me qëllim informimin dhe festimin e saj në mënyrën e duhur.



TRAJNIME PËR PUNËSIM

Kurse profesionale

Gjatë vitit 2010, 34 raste kanë ndjekur kurse të ndryshme profesionale dhe trajnime për punësim kryesisht: parukeri, rrobaqepësi, kuzhinë, punëtore shtëpie, anglisht, kompjuter. Për regjistrimin dhe ndjekjen e kurseve pa pagese, D&E ka bashkëpunuar me Zyrën e Punësimit dhe Alternativës Profesionale. Disa prej këtyre përfituesve kanë ndjekur më shumë se një kurs. Në përzgjedhjen e kurseve përfitueset janë mbështetur dhe orientuar nga punonjëset duke u bazuar në aftësitë e tyre personale, pritshmëritë dhe planet e tyre për të ardhmen. Për përfitueset, ndjekja e kurseve konsiderohet si një shans i mirë për përgatitjen e tyre për të ardhmen dhe mundësinë e punësimit.

PËRGATITJA PËR PUNË DHE PUNËSIMI

Këtë vit 26 përfituese kanë qënë të punësuar kryesisht si: rrobaqepëse, kuzhinierë, asistente kuzhinierë, shitëse në dyqan, banakierë, pjatolarëse, pastruese, arkëtare, operatore, parukierë, operatore kompjuteri në Internet Kafé, lavanderi, magazinierë etj.

D&E ka zgjeruar mundësinë për të punuar pranë saj, të 2 përfituesve të cilat janë punësuar si magazinierë dhe sanitare brenda organizatës me mbështetjen financiare të UN.GIFT/UNODC.

Gjatë vitit 2010, 5 përfituese kanë hapur bizneset e tyre. 2 përfituese kanë hapur mini rrobaqepësi me grante mbështetur nga IOM, një në Kavajë e tjetra në Durrës. Përmes këtij granti, përfitueset përfituan makinë qepëse profesionale, hekur profesional për hekurosje, materiale të tjera të nevojshme dhe në të njëjtën kohë, për të rritur aftësitë e

Kurse profesionale/trainime për punësim

Kursi	Ofruar	Nr i rasteve
Kuzhine	Qendra Profesionale Alternativa	3
Kompjuter	Qendra e trainimeve profesionale Tiranë	14
Parukeri	Qendra e trainimeve profesionale Tiranë Sallon bukurie Durrës Sallon bukurie Vlorë	8
Rrobaqepsi	Qendra e trainimeve profesionale Tiranë Qendra e trainimeve profesionale Kavajë	5
Pikturë/Dizenjim	Trainer profesionist	14
Anglisht	Vullnetare e huaj	16
Estetikë	Sallon bukurie Tiranë	1
Anglisht	Qendra e trainimeve profesionale Tiranë	3
Punime artizanale	Trajnere	10



tyre profesionale, kanë ndjekur kurs të avancuar rrobaqepsie. Në fund të muajit dhjetor tri përfituese të tjera të programit të D&E kanë hapur dyqanet e tyre të parukerisë, njëra prej tyre e mbështetur me grant riintegrimi të marrë nga IOM Norvegjia dhe gjithashtu me mbështetjen e vazhdueshme të D&E dhe IOM Tiranës. Biznesi i parë u hap në Tiranë dhe dy të tjerët në qytetin e Durrësit. Përfitueseve iu janë siguruar të gjitha pajisjet e nevojshme për të hapur dyqanet e parukerisë dhe janë mbështetur financiarisht me pagesën e qerasë së dyqanit për tre muajt e parë. Para hapjes së bizneseve çdo përfituese u ndihmua të përgatiste një plan biznesi. Gjatë 2010, D&E ka patur kontakte të rregullta me Zyrën Rajonale të Punësimit dhe të gjitha përfitueset e programit janë rregjistruar pranë kësaj zyre. Një prej përfitueseve u përfshi gjatë këtij viti në programin e nxitjes së punësimit.

NDIHMA PËR ARSIMIM

Pas një vlerësimi të bërë për përcaktimin e nivelit arsimor të çdo përfitueseje, është zhvilluar një plan edukativo-mësimor si pjesë e planit të riintegrit të çdo përfitueseje.

Gjatë vitit 2010, kanë ndjekur shkollën 20 përfituese ku 10 prej tyre janë rregjistruar këtë vit.

Për rregjistrimin e përfitueseve në shkollë për vitin shkollor 2010-2011 është mbledhur dokumentacioni i nevojshëm. Për sigurimin e këtyre dokumentave është angazhuar jo vetëm stafi i punës në qendrën rezidenciale por edhe familjarët e përfitueseve. Në mënyrë që të sigurohen dokumentat në kohën e duhur stafi ka udhëtuar në vëndet e banimit të përfitueseve për t'i pajisur me dokumentacionin përkatës për rregjistrim. Udhëtime të tilla janë bërë në Shkodër, Lezhë, Durrës dhe Tiranë.

D&E është mbështetur nga zyra e Zyra e Koordinatorit Kombëtar antitrafik për ndërmjetsimin me Ministrinë e Arsimit, për të vendosur bashkëpunimin me Drejtorinë Rajonale të Durrësit dhe shkollën e mesme në një komunë të Durrësit duke i mundësuar një përfaqësuese të jepte 15 provime të klasës së 10-të në mënyrë që të rregjistrohej në klasën e 11-të në Tiranë.

Të gjitha rastet që kanë ndjekur shkollën gjatë vitit 2010 janë mbështetur nga mësuesja e D&E

Ndjekja e shkollës	Nr i rasteve
9-vjeçare	5
E Mesme	13
Universitetin	2

Shoqërimi i përfitueseve në konsultimet e zhvilluara në shkollë

Ndihmë mësimore për përfitueset të cilat nuk kanë ndjekur shkollë formale

Paisja e përfitueseve me mjetet dhe librat e nevojshëm

Ndihmë në studimin e lëndëve të ndryshme për provim



AKTIVITETE SOCIALE

Aktivitete të organizuara brenda qendrës

Diskutimet në grup

Një ndër aktivitetet e rëndësishme në të cilën përfitueset marrin pjesë janë diskutimet e temave të ndryshme në grup. Ky lloj aktiviteti i shërben jo vetëm informimit të përfitueseve në lidhje me tema të ndryshme por edhe modelimit të një sjellje të përshtatshme në grup dhe përpara antarëve të grupit. Gjatë vitit 2010 janë realizuar disa takime grupesh me qëllim diskutimin e temave të caktuara si:

- Menaxhimi i të ardhurave dhe menaxhimi i kohës së lirë
- Motivimi dhe llojet e motivimit
- Altruizmi dhe ndihma shoqërore
- Konfliktet dhe menaxhimi i tyre
- Paragjykimi dhe diskriminimi
- Vullnetarizmi dhe rëndësia
- Etj.

Festimet e ditëve të shënuara

Rëndësi e veçantë i është kushtuar festimit të ditëve të shënuara nga përfitueset. Festimi, sidomos i festave fetare të çdo besimi, pa përjashtim, ka bërë që vajzat të ndihen të respektuara në besimin e tyre. Gjithashtu për festën e Vitit të Ri janë shpërndarë dhurata të ofruara nga organizata për përfitueset dhe fëmijët e gjithashtu nga SFI (Fondacioni Zvicerian Ndërkombëtar). Ditëlindjet e përfituesve janë festuar me dhurata, tortë, ushqime të veçanta dhe muzikë.

Terapi arti

Terapia e artit është një mënyrë e zbulimit të rasteve për të shkuar në brendësi të emocionit, mendimit dhe ndjenjës. Përfitimet në këtë mënyrë të shprehuri nuk mbeten vetëm në planin e eksplorimit të emocionit dhe mendimit por edhe në efektin terapeutik që ka kjo formë terapie. Një nga mënyrat se si terapia e artit ka kontribuar që përfitueset të ndihen me vetëbesim dhe vetëvlerësim më të lartë, ka të bëjë me krijimet dhe produktet e perfituara nga terapia. Komponentët kreativë dhe analitikë të këtij procesi artistik u kanë dhënë përfitueseve një ndjenjë vetë-vlefshmërie duke ushqyer kështu një nivel më të lartë vetëvlerësimi.

Përfitueset përjetojnë stres kronik i cili ndikon në dëmtimin jo vetëm të mendjes por edhe të trupit, për t'u bërë më pas shkak në dobësimin e sistemit imun. Në lidhje me këtë është parë që terapia e artit ndihmon përfitueset të çlirojnë efektivisht stresin përmes terapisë së artit kombinuar ose jo me teknika të tjera relaksuese. Në këtë mënyrë, terapia e artit jo vetëm që ka ndihmuar në çlirimin e emocioneve por edhe në shprehjen e tyre.



Ajo gjithashtu ka ndihmuar vajzat për të nxjerrë në sipërfaqe frikëra dhe emocione të ndryshme. Kjo u ka dhënë atyre një ndjenjë kontrolli mbi këto emocione. Ajo ka pasur efekte lehtësuese kur përfitueset identifikojnë punimin artistik me zemërimin, inatin dhe emocione të tjera. Terapia e artit është parë nga përfitueset si një mënyrë alternative e shprehjes së vetes.

Aktivitete të tjera

Një sërë aktivitesh të tjera janë organizuar për përfitueset. Përfitueset kanë marrë pjesë në seminarët e kuzhinës ku kanë mësuar gatime tradicionale. Vizita janë bërë në pika historike si kalaja e Krujës, e Prezës, e Shkodrës. Për disa prej tyre, ishte hera e parë që ju jepej mundësia të vizitonin këto vende të rëndësishme të historisë shqiptare.

Gjatë verës D&E u ka ofruar përfitueseve mundësinë për të kaluar disa ditë pushimi në një pishinë në Tiranë. D&E gjithashtu ka organizuar vizita në Galerinë e Arteve, të cilat janë pëlqyer mjaft nga përfitueset.

AKTIVITETE ME GJENERIM TË ARDHURASH

Në bashkëpunim me Shoqatën e Grave dhe Vajzave Shqiptare (AAGW), përfitueset e D&E janë përfshirë në përgatitjen e punëve të dorës të cilat më pas ose janë përdorur për vetë ato dhe fëmijët e tyre, ose janë shitur dhe të ardhurat nga shitja u janë shpërndarë po atyre. Këto janë aktivitete me të cilat vajzat zënë kohën e lirë në mënyra të ndryshme e koha që ato kalojnë në qendër të vlejë për rritjen e aftësive për jetën si dhe për përfitim të ardhurash. Ndër punimet e përfitueseve janë qëndisimat, punët me shtiza, qepje me makinë. Ato prodhojnë gjëra për vete, fëmijët e tyre, apo edhe për Qendrën e Ri-integritimit.

Gjatë periudhës së raportimit është bërë e mundur edhe një bashkëpunim me një organizatë tjetër “ World Vision” e cila dy herë gjatë vitit u ka ofruar përfitueseve materialet për të bërë qëndisima.

Në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit, përfitueset kanë bërë punime të ndryshme për t’i paraqitur apo shitur në panairë. Një Panair është bërë në Maj dhe një tjetër në prag të festave të fund vitit, për Krishtlindje. Punimet e vajzave janë shitur gjithashtu në një konferencë të organizuar në Shkodër dhe dy në Tiranë.

Zënia e kohës së lirë me këto lloj aktivitetesh është parë si një lloj terapie për përfitueset, pasi këto lloj aktivitetesh përveçse, u zënë kohën e lirë në mënyrë produktive por edhe u japin kënaqësi, u rrisin vetëvlerësimin dhe vetbesimin.

Në mbështetje të këtij aktiviteti, D&E ka punësuar një trajnuese për një kohë të caktuar që t’u mësojë vajzave për të përgatitur punime të bukura dhe të ndryshme që mund të shiten në treg, kryesisht për Krishtlindje dhe për Vitin e Ri. Kështu përfitueset kanë arritur të bëjnë qëndisima si çanta vere, çanta dhuratash, çanta për shopping, mbajtëse bizhush, celularësh, syzesh, shalle, zbukurime për pemën e Vitit të Ri, doreza, çorape etj. Shumë nga këto punime janë shitur në panairin e organizuar në Dhjetor për Krishtlindje.





Projekti 2:

“Fuqizimi i nënave të reja, viktima të trafikimit dhe dhunës, për të rritur fëmijë të shëndetshëm”

Financuar nga Ambasada Amerikane në Tiranë

Periudha: Korrik 2010 – Shkurt 2011

Ky projekt synonte t’ju ofronte nënave në program njohuritë dhe aftësitë e nevojshme mbi aspektet e zhvillimit të fëmijëve, kujdesit dhe shërbimeve për to.

Në vijim, projekti do ti përgatiste nënat dhe fëmijët për një jetë të sigurtë, të shëndetshme dhe të pavarur. Projekti gjithashtu u përdor për të rritur afësitë e stafit të D&E duke i pajisur ata me aftësitë e nevojshme për të ndihmuar nënat dhe fëmijët që asisitohen nga D&E.

Aktivitetet e realizuara për zbatimin e këtij projekti janë:

KLASA MËMËSIE DHE PRINDËRIMI

Klasat e mëmësisë dhe prindërimit janë organizuar për 17 përfituese të D&E. Këto klasa janë organizuar në bashkëpunim me një psikolog profesionist nga Shërbimi Social Bethany.

Qëllimi kryesor i këtij kursi ishte të mbështeste nënat e reja me një paketë të plotë informacioni mbi shtatëzaninë dhe prindërimin. Këto klasa i trajnuan dhe aftësuan nën kujdesin për të porsalindurin dhe sesi të përmbushin më mirë nevojat e fëmijëve. Këto klasa u vlerësuan të rëndësishme edhe për të forcuar lidhjen e nënave me fëmijët e tyre.

TRAINIM MBI NDIHMËN E PARË

Shtatë sesione të ndihmës së parë janë realizuar nga një pediatre. Qëllimi kryesor i këtij trajnimi ishte të përgatiste nënat e reja sesi të reagojnë në situata emergjente me fëmijët e tyre si temperaturë e lartë, helmimi, djegiet, dhimbjet e stomakut, enjtjet etj. Ky ishte një trajnim i rëndësishëm veçanërisht për nënat që jetojnë jashtë strehëzës me fëmijët e tyre por gjithashtu edhe për të përgatitur vajzat që janë në strehez për të menaxhuar më mirë këto lloj situatash, kur janë vetëm. 17 përfituese kanë marrë pjesë në trajnim.

Për nënat që morën pjesë në trajnim, D&E përgatiti dhe shpërndau paketa të ndihmës së parë në bashkëpunim me trajneren.



INFORMACION PËR SHËRBIMET NË KOMUNITET

Objektivat kryesore të këtij aktiviteti ishin të ofronte një informacion të plotë mbi shërbimet e ofruara në komunitet bazuar në nevojat ditore të çdo përfitueseje; identifikimi i shërbimeve të ofruara nga institucionet shtetërore dhe organizatat jofitimprurëse; shpërndarja e informacionit bazë mbi këto lloj shërbimesh që ofrohen nga secili institucion dhe informacionet e mundshme të kontaktit.

Një workshop është organizuar për përfitueset e D&E të fazës së dytë dhe të tretë të programit të riintegritit për të informuar nënat e reja për shërbimet e mundshme të ofruara në komunitet nga institucionet shtetërore dhe joshtetërore. Një hartë e shërbimeve në komunitet është përgatitur dhe shpërndarë për të gjitha nënat që marrën pjesë në workshop. Një tjetër workshop do të organizohet me nënat të cilat janë aktualisht të akomoduar në Qendrën e Riintegritit. Dhe faza e fundit e këtij aktiviteti është shoqërimi në mënyrë direkte i përfitueseve në institucione të ndryshme shtetërore ose jo shtetërore.

VLERËSIM PSIKOLOGJIK I FËMIJËVE

D&E ka bashkëpunuar me një psikolog fëmijësh për të realizuar një vlerësim psikologjik mbi aspektet e zhvillimit të të gjithë fëmijëve që asisitohen bashkë me nënat e tyre në programin e D&E. Seanca individuale këshillimi të psikologut me nënat e fëmijëve u mundësuan për të ndihmuar nënat për të kuptuar më mirë nevojat e zhvillimit të fëmijëve të tyre dhe për ti ndihmuar ata të rriten në mënyrë të shëndetshme. Në total 16 fëmijë të përfituesve të grup –moshave të ndryshme janë përfshirë në këto vlerësime. Format e vlerësimit për çdo fëmijë janë bazuar në komponentë të ndryshëm si historia familjare (marrëdhënia me familjen, marrëdhënia me bashkëmoshatarët, koha e lirë, edukimi), situata aktuale (gjendja fizike, fusha afektive, fusha kognitive, sjella sociale) etj. Gjithashtu edhe një listë kontrolli është realizuar më çdo fëmijë bazuar në moshën e tyre, ku janë theksuar elementë si socializimi, aftësitë për të ndihmuar veten, zhvillimi gjuhësor etj..

TRAINIM PËR STAFIN E D&E

Për stafin e D&E u organizua në muajin Dhjetor trainimi mbi aspektet psikologjike dhe sociale të asistencës dhe ri-integritit të viktimave të trafikimit dhe të dhunës dhe fëmijëve të tyre duke u fokusuar veçanërisht në zhvillimin psikologjik të fëmijëve; menaxhimin e rasteve me eksperiencë traumatike dhe aspekte të shëndetit mendor. Trainime të tjera do të organizohen në muajt në vijim mbi aspektet ligjore, me fokus të veçantë në të drejtat e grave sipas legjislacionit shqiptar, mbi procedurat e adoptimit dhe kujdestarisë së fëmijëve dhe mbi aspektet ligjore e praktike të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.



Projekti 3:

“Përmirësimi i kushteve të Qendrës së Ri-integrimit për viktimat shqiptare të trafikimit”

Periudha e zbatimit të projektit: Shkurt-Prill 2010

Financuar nga: TIKA – Agjensia Turke për Zhvillim dhe Bashkëpunim

Ky projekt synoi përmirësimin e kushteve të Qendrës së Ri-integrimit dhe ofrimin e një ambjenti të përshtatshëm për përfitueset e programit dhe fëmijët e tyre.



Falë mbështetjes bujare të Agjensisë Turke për Zhvillim dhe Bashkëpunim (TIKA) u mundësua zëvendësimi i të gjitha mobiljeve të qendrës me mobilje të reja, duke filluar që nga dhomat e gjumit të vajzave me krevate, dollapë, krevate fëmijësh, tapete, dhoma e ndenjes ku janë vendosur kolltuqe të reja, televizor, tavolinë mesi; kuzhina me tavolina e karrike të reja, dollapët e kuzhinës etj.

Projekti 4:

“Rritja e aftësive për jetën e viktimat shqiptare të trafikimit përmes trajnimeve dhe aktiviteteve edukuese”

Periudha Janar-Qershor 2010

Financuar nga: Ambasada Australiane në Athinë

Ky projekt u dizajnuar për të mbështetur viktimat shqiptare të trafikimit në rritjen e aftësive për jetën, përmes trajnimeve dhe aktiviteteve edukuese.

Me anë të këtij projekti D&E asistoi viktimat e trafikimit dhe ato në rrezik trafikimi, për të përballuar më mirë sfidat e ri-integrimit në jetën normale. Kjo është arritur nëpërmjet kurseve profesionale, mbështetjes për t'u integruar në tregun e punës, mbështetjes për të vazhduar shkollën dhe trajnimeve për çështje të rëndësishme.

MBËSHTETJE PËR KURSET PROFESIONALE

Me mbështetjen financiare të këtij projekti u paguan disa kurse që nuk mund të ofroheshin falas nga Qendra e Formimit Profesional si pagesa e një kursi estetike për një përfituese, pagesa e një kursi kuzhine si dhe organizimi i një kursi për dizajnim dhe pikturë nëpërmjet një profesionisti të kontraktuar nga D&E në të cilin morën pjesë 10 përfituese të programit.

Idea për kursin e Pikturës dhe Dizajnimit erdhi fillimisht nga përfitueset dhe u mbështet fuqishëm nga stafi duke patur parasysh vlerën e Terapisë së Artit në grupet e traumatizuara dhe vulnerabël.



Mbështetje me materialet e nevojshme për ato që ndjekin shkollën

Me anë të projektit u mbështetën edhe përfitueset e D&E që ndjekin shkollën, kryesisht për blerjen e librave dhe mjeteve të nevojshme mësimore si dhe për pagesat e ndryshme gjatë përgatitjes së dokumentave të nevojshme për rregjistrimin e tyre në sistemin arsimor etj. Gjithashtu u blenë edhe disa libra artistikë për bibliotekën e Qendrës së Ri-integrimit.

TRAJNIME NË FUSHA TË RËNDËSISHME PËR JETËN

Trajnim mbi të drejtat e njeriut

Trajnimi mbi Të Drejtat e Njeriut është organizuar më 19 Shkurt 2010 ofruar nga një trainer specialist në këtë fushë. Çështjet e diskutuara në këtë trajnim kanë qënë: cilat janë të drejtat e njeriut, burimet kryesore të konceptit të të drejtave të njeriut, Legjislacioni Shqiptar mbi trafikimin, të drejtat bazë të viktimave të trafikimit përballë Institucioneve Ligjore Shqiptare etj. Të gjitha përfitueset në Qendrën e Riintegritit dhe disa përfituese të fazës së dytë dhe të tretë të programit morën pjesë në trajnimin e organizuar në zyrën e D&E.

Trajnim mbi shëndetin, shëndetin mendor dhe mirëqënien

Trajnimi mbi shëndetin në përgjithësi është organizuar më 25 Janar 2010, ofruar nga një mjek. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë të gjitha përfitueset e akomoduar në Qëndren Ri-integruese. Çështjet e diskutuara ishin: si të njohim shkaqet e çrregullimeve të shëndetit mendor dhe si të bëjmë referimin tek specialisti, çrregullimet e stresit post –traumatik, stresit dhe çrregullimet e ankthit etj. Përfitueset treguan shumë interes për trajnimin.

Trajnim mbi tregun e punës

Trajnimi mbi tregun e punës është organizuar në 16 Mars 2010. Çështjet kryesore të diskutuara në këtë trajnim kanë qënë: si të kërkosh dhe të gesh një punë, modele për një interviste pune të suksesshme, si të bësh një CV (format i të dhënave personale) etj. Trajnimi ka qënë shumë i dobishëm për përfitueset që ishin në fazën e përgatitjes për të kaluar në fazën e dytë të procesit të ri-integrimit.

Trajnim mbi marrëdhëniet njerëzore

Trajnimi mbi marrëdhëniet njerëzore është organizuar më 21 Prill 2010. Pas eksperiencave të trafikimit, viktimat hasin vështirësi në krijimin e marrëdhënieve të shëndetshme dhe të besueshme ndërpersonale. Kjo është edhe arsyeja pse përfitueset e pritën me kuriozitet këtë trajnim. Ato ishin tërësisht të përfshira në diskutime konkrete. Çështjet kryesore të diskutuara gjatë trajnimit ishin: format e komunikimit, parimet e një komunikimi të mirë, menaxhimi i konflikteve, modele mbi krijimin e marrëdhënieve të shëndetshme me shokë, kolegë, partnere etj.



Trajnim mbi shërbimet në komunitet

Trajnimi mbi shërbimet në komunitet është organizuar më 24 Qershor 2010.

Përfitueset janë informuar mbi të gjitha shërbimet potenciale të ofruara nga komuniteti. Ky informacion është i domosdoshëm për të gjitha ato, që do të kalojnë në fazën e dytë të programit dhe do të bëjnë një jetë gjysëm të pavarur.

Përfitueset u informuan mbi shërbimet e ndryshme që ofroreshin nga Qendrat e Shëndetit Publik, kopshtet, Zyra Rajonale e Punësimit, zyrat e gjendjes civile, programet e Bashkisë, mundësinë e gjetjes së vendeve të punës dhe kurseve profesionale etj.

4. DONATORËT:

- USAID/IOM
- Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë
- TIKA- Agjencia Turke për Zhvillim
- KBF- King Baudouin Foundation
- Ministria e Jashtme e Norvegjisë
- Vodafone Foundation Albania
- MIVA Holand
- UN.GIFT – Iniciativa Globale e Kombeve të Bashkuara në Luftën e Trafikimit
- UN.OHCHR - Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut e Kombeve të Bashkuara
- SRTV Holandë – Fondacioni Fetar Holandez kundër trafikimit
- Ambasada e Australisë në Athinë/Programi i Ndihmes direkte (DAP)

PARTNERËT NDËRKOMBËTARË

IOM, OSCE, US Embassy, European Commission, ICMPD, KBF, UNODC, UNOHCHR, UNICEF, UNIFEM/ UN Women, ICITAP, OPDAT



BASHKËPUNËTORËT KRYESORË GJATË 2010

Nr	EMRI I INSTITUCIONIT/ ORGANIZATËS	LLOJI I BASHKËPUNIMIT
1.	Ministria e Brendshme - Zyra e Koordinatorit Kombëtar Kundër Trafikimit në Njerëz	<p>Bashkëpunim me Zyrën e Koordinatorit Kombëtar për Mekanizimin Kombëtar të Referimit</p> <p>Bashkëpunim në adresimin dhe zgjidhjen e problemeve e çështjeve të ndryshme në lidhje me përfitueset e programit të D&E</p> <p>Bashkëpunim dhe pjesëmarrje aktive në aktivitetet e organizuara nga Koordinatorit Kombëtar si në hartimin e Strategjisë Kombëtare Anti-trafik 2011-2013 dhe në finalizimin e Procedurave Standarte të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e viktimave të trafikimit</p>
2.	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë dhe Drejtoritë e Qarkut të Tiranës, Durrësit, Korçës, Burrelit, Fierit, Lezhës, Laçit, Elbasanit.	<p>Burim referimi për rastet viktime trafikimi ose viktime të mundshme trafikimi</p> <p>Bashkëpunim për përfitueset që kanë denoncuar shfrytëzuesit, për sigurinë e përfituesve</p> <p>Lehtësimi i takimeve me familjarët e përfitueseve të organizuara në ambjentet e policisë</p> <p>Shoqërimi i përfitueseve në takimet me familjarët pranë familjeve të tyre në qytete të ndryshme</p> <p>Sigurimi i dokumentave të identifikimit për përfitueset</p>
3.	Autoriteti Përgjegjës	<p>Burim referimi për rastet viktime trafikimi dhe viktime të mundshme trafikimi</p> <p>Diskutimi dhe adresimi i problematikave të rasteve të vështira të referuara nga qendrat</p> <p>Bashkëpunim në zgjidhjen e situatave lidhur me sigurinë e përfitueseve dhe qendrës</p> <p>D&E raporton dhe informon Autoritetin Përgjegjës në lidhje me referimin, largimet dhe bashkëpunon për zgjidhjen e situatave dhe nevojave specifike të përfitueseve në programin e D&E</p>



No	EMRI I INSTITUCIONIT/ ORGANIZATËS	LLOJI I BASHKËPUNIMIT
4.	Prokuroria e Krimeve të Rënda	Bashkëpunim për rastet që kanë një proces penal Bashkëpunim në sigurimin e informacioneve mbi këto çështje dhe progresin e tyre Burim referimi për rastet viktime trafikimi
5.	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Shërbimi Social Shtetëror dhe Zyra Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror	Burimi referimi për rastet viktime të trafikimit dhe viktime të dhunës në familje Organizata është inspektuar nga inspektorët e Shërbimit Social Shtetëror për zbatimin e Standarteve për Shërbimet e Përkujdesit Shoqëror për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi në Qëndrat Rezidenciale Pjesëmarrje aktive në aktivitetet e organizuara nga MPÇSSHB
6.	Zyra Rajonale e Punës dhe Drejtoria e Formimit Profesional Nr. 4	Rregjistrimi i të gjitha përfituesve në program Ofrimi i mundësisë nga Programi i Nxitjes së Punësimit, në të cilin këtë vit është përfshirë një nga përfitueset e programit të D&E Ofrimi i kurseve profesionale falas ose me pagesë të vogël për përfitueset në program
7.	Ministria e Arsimit, Drejtoria Rajonale e Arsimit dhe Drejtoritë e Shkollave	Rregjistrimi i përfitueseve në sistemin shkollor Ofrimi i lehtësirave për përgatitjen e dokumentave të nevojshme për përfshirjen e përfituesev në sistemin shkollor Rregjistrimi i fëmijëve në kopësht

No	EMRI I INSTITUCIONIT/ ORGANIZATËS	LLOJI I BASHKËPUNIMIT
8.	Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile	Rregjistrimi i përfituesve dhe fëmijëve të tyre në gjendje civile
9.	Bashkia Tiranë	Mbështetje për regjistrimin falas të fëmijëve në çerdhe
10.	Koalicioni i Strehëzave Anti -Trafik	Bashkëpunim për referimin dhe ofrimin e asistencës rasteve viktime trafikimi apo viktime të mundshme trafikimi Ofrimi i ekspertizës për hartimin e politikave Kombëtare në mbështetjen të viktimave të trafikimit Shkëmbimi i eksperiencave dhe ekspertizës duke koordinuar veprimet dhe në përputhje me procedurat standarte operationale për viktimat e trafikimit
11.	Qendra për Nisma Ligjore Qytetare	Ofrimi i mbështetjes ligjore për përfitueset e programit të D&E Burim referimi për rastet viktime trafikimi ose të dhunës në familje Stafi i D&E është ftuar për të marrë pjesë në trajnime të ndryshme të organizuar nga stafi i kualifikuar i QNLQ
12.	Terre des Homes	Burim referimi për rastet viktime trafikimi dhe viktime të mundshme trafikimi
13.	Motrat e Nënë Terezës	Ofrimi i mbështetjes financiare për disa nga përfitueset e programit të D&E Burim referimi Vend akomodimi për përfitueset me nevoja të veçanta



No	EMRI I INSTITUCIONIT/ ORGANIZATËS	LLOJI I BASHKËPUNIMIT
14.	Linja e Këshillimit për Gratë dhe Vajzat dhe Strehëza për Gratë e Abuzuara	Burim referimi për gratë dhe vajzat viktime të dhunës në familje dhe bashkëpunim për referimin nga Sheltersi për Gratë të dhunuara të viktimave të mundshme të trafikimit
15.	Shoqata "Në Dobi të Guras Shqiptare"	Burim referimi Bashkëpunim me Qendrën "Alternativa Profesionale" për përfitueset e D&E që ndjekin kurs kuzhine
16.	AAGW (Shoqata Shqiptare e Grave dhe Vajzave)	Aktivitetet për rritjen e të ardhurave për përfitueset në program Aktivitetet për rritjen e aftësive për jetën
17.	CARITAS	Burim referimi
18.	Fakulteti i Shkencave Sociale	Dhënia e mundësisë studentëve për të zhvilluar praktikën pranë organizatës D&E. Ofrimi i trajnimeve ose leksioneve mbi çështje të trafikimit për studentët e Fakultetit të Shkencave Sociale, dega punë Sociale, psikologji, shkenca politike, sociologji dhe studentëve të masterit
19.	Shoqata Kristiane e Të Burgosurave Shqiptarë (SHKBSH)	Ofrimi i mbështetjes financiare për përfitueset në fazën e dytë dhe të tretë të programit të D&E, për pagesën e qerasë së shtëpisë dhe pagesa të tjera për përfitueset ose fëmijët e tyre Ofrimi i mundësisë për të ndjekur kurs profesional parukerie dhe për t'u praktikuar pranë sallonit të bukursë "SHARM"



5. TRAINIME PËR RRRITJEN E KAPACITETIT TË STAFIT TË D&E-së

STAFI

29-31 Mars 2010

Pjesëmarrje në trainimin e organizuar nga TASCOS mbi “Procedurat e aplikimit për grante nga BE”

23 Gusht 2010 – Pjesëmarrje në trainimin e organizuar nga IOM “ Menaxhimi i stresit”

6,7,8 dhe 13,14,15 Shtator 2010 – Pjesëmarrje në trainimin e organizuar nga Shërbimi Social Shtetëror dhe UNICEF “Implementimi standarteve të shërbimeve të kujdesit social në qendrat rezidenciale për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi”.

Drejtoresha Ekzekutive e organizatës ka ndjekur një kurs afatgjatë për “Menaxhimin” me mbështetjen financiare të IOM Tiranës.

17 Nëntor 2010 – Pjesëmarrje në trainimin organizuar nga D&E në bashkëpunim me Sr. Dagma Plum (MMS) “Situata e trafikimit të qënieve njerëzore në Gjermani- një shkëmbim eksperiencash”

19 Nëntor 2010 – Pjesëmarrje në trainimin organizuar nga Ministria e Brëndshme dhe IOM mbi “Procedurat Standarte të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave të Trafikimit dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit”.

20 Dhjetor 2010 – Pjesëmarrje në trainimin e organizuar nga D&E dhe ofruar nga një psikologe specialiste “Aspektet psikologjike dhe sociale në zhvillimin e fëmijës”.

21 Dhjetor 2010 – Pjesëmarrje në trainimin organizuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare “Fuqizimi i kapaciteteve të shoqërisë civile, për përdorimin e instrumentave në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të qytetarëve”.

TRAINIME OFRUAR PËR NGO-s, INSTITUCIONE SHTETËRORE DHE AKTORË TË TJERË

Janar 2010

11-12: Drejtorja Ekzekutive është ftuar nga OPDAT për të prezantuar në trajnimin e organizuar për Prokurorët dhe Gjyqtarët mbi “Nevojat dhe shërbimet për viktimat e trafikimit në Shqipëri”.



Maj 2010

27-28: Drejtorja Ekzekutive ka ofruar prezantim si bashkë-trainuese për Gazetarët Shqiptarë mbi “Raportim i Trafikimit Njerëzor” organizuar nga IOM, Insituti Shqiptar i Medias dhe Zyra e Koordinatorit Kombëtar Anti-trafik.

Drejtorja Ekzekutive dhe Koodinatorja e Riintegritit kanë mbajtur leksione mbi “Asistencën Riintegruese për Viktimat e Tafikimit” për studentët e Fakultetit të Shkencave Sociale.

Nëntor 2010

04: Një workshop u organizua me një grup prej 14 studentësh të degës së Punës Sociale, nga Universiteti St. Gallen në Zvicër. Temat e prezantuara në këtë sesion të Workshop-it ishin: Prezantimi i Programit të Riintegritit të organizatës, profili i viktimave të trafikimit, format e trafikimit, elementë të riintegritit të suksesshëm, menaxhimi i rasteve të vështira, rëndësia e bashkëpunimit me institucionet qeveritare dhe jo-qeveritare për të adresuar më mirë nevojat specifike të viktimave të trafikimit në Shqipëri.

Nëntor 2010

18-19: Dy trajnime të tjera janë organizuar nga D&E për një grup grash biznesmene, anëtare të Shoqatës së Grave Profesioniste, Afariste dhe Zejtare të Shqipërisë. Në trainim morën pjesë në total 16 gra. Çështjet kryesore të diskutuara ishin: prezantimi i programit riintegrues të organizatës, profili i viktimave të trafikimit, format e trafikimit, komponentë të riintegritit të suksesshëm, rëndësia e marrjes së një zanati gjatë procesit të riintegritit për viktimat e trafikimit dhe atyre në rrezik trafikimi, sfida kryesore dhe vështirësitë në gjetjen e një vendi pune të përshtatshëm dhe të sigurt, gjenerimi i mundësive të reja të punësimit për përfitueset e D&E, në bashkëpunim me gratë biznesmene të shoqatës SHGPAZ.

6. PJESËMARRJE NË AKTIVITETE TË NDRYSHME

18 Janar 2010 – Pjesëmarrje në promovimin e manualit “Gjinia dhe të drejtat e njeriut, Qytetaria, Dhuna në Familje, Integrimi European, Media, Shëndeti Riprodhues, Karriera, Zhvillimi dhe mjedisi” organizuar nga Aleanca Gjinore për Zhvillim.

Shkurt 2010 – Pjesëmarrje në takimin organizuar nga Këshilli Britanik, mbi “Promovimin e javës gjithëpërfshirëse të personave me aftësi të kufizuara”.



19 Prill 2010 – Pjesëmarrje në Konferencën “Menaxhimi i migracionit shqiptar: rishikimi i arritjeve dhe sistemeve të politikave” organizuar nga IOM dhe Ministria e Punëve të Jashtme të Italisë.

26 Maj 2010 – Pjesëmarrje në Konferencën “Promovimi i Barazisë Gjinore - në Zhvillim, ndarja e eksperiencave të suksesshme të Kooperacionit Zvicerian në Shqipëri, organizuar nga Aleanca Gjinore për Zhvillim dhe SCO.

27 Maj 2010 – Pjesëmarrje në Konferencën finale në kuadër të projektit: “Parandalimi i emigrimit të fëmijëve” organizuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanceve të Barabarta dhe Zyra e Bashkëpunimit e Europës.

28 Maj 2010 – Pjesëmarrje në takimin konsultativ rreth Dokumentit draft Strategjik për Riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe ripranuar, organizuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

31 Maj - 4 Qershor 2010 – Pjesëmarrje në një vizitë në Itali në kuadër të projektit MINORI mbi “Hartimin e kuadrit ligjor për Ndërmarrjet Sociale” organizuar nga RER në disa Ndërmarrje Sociale dhe organizata në Forli, Itali.

1 Qershor 2010 – Pjesëmarrje në eventin organizuar për fillimin e Lojrave Speciale Olimpikë, financuar nga Fondacioni Vodafone Albania.

7 - 10 Qershor 2010 – Pjesëmarrje në takimin e tretë të partnerëve të Programit të Riintegrimin për Viktimat e Trafikimit organizuar nga KBF në Pomorie, Bullgari.

17 - 19 Qershor 2010 – Pjesëmarrje në takimin me OJF mbi “Skllavërinë e shërbyesve” e organizuar nga OSCE.

23 Qershor 2010 – Pjesëmarrje në konferencën “Fuqizimi i Grave mbi te drejtat e punës në Shqipëri”, organizuar nga Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim.

29 Qershor 2010 – Pjesëmarrje në pritjen organizuar nga Ambasada Amerikane, për njohjen dhe mbështetjen e Programit të Granteve të vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasades se SH.B.A.



29 Qershor 2010 – Pjesëmarrje në lancimin e Protokollit të Punës së stafit për Mbrojtjen e Fëmijëve, organizuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, UNICEF dhe Terre des Hommes.

29 Qershor - 1 Korrik 2010 – Pjesëmarrje në një vizitë për shkëmbime eksperiencash në Mbretërinë e Bashkuar, organizuar nga OSBE.

1 Korrik 2010 – Pjesëmarrje në grupin e punës për parandalimin dhe luftën kundër shfrytëzimit të fëmijëve për punë, organizuar nga Ministria e Brendshme. D&E ka marrë pjesë në dy takime gjatë kësaj periudhe.

5 Korrik 2010 – Pjesëmarrje aktive në workshop-in për të finalizuar procedurat standarte operative, të organizuara nga Ministria e Brendshme dhe IOM.

8 Korrik 2010 – Pjesëmarrje në një takim mes Cherry Bler dhe përfaqësuesve të OJF-ve në Shqipëri që punojnë në fushën e anti-trafikut dhe dhunës ndaj grave, organizuar nga Ambasada Britanike në Tiranë.

26 Korrik 2010 – Pjesëmarrje në takimin organizuar nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

1 Shtator 2010 – Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga Ambasada Amerikane për të rritur bashkëpunimin mes Qeverisë Shqiptare dhe Qëndrave rehabilituese dhe riintegruese për VeT.

8 Shtator 2010 – Pjesëmarrje në workshop për përdorimin e Protokollit Shtesë të CEDAW, organizuar nga UNIFEM.

8 Shtator 2010 – Pjesëmarrje në takimin mes përfaqësuesve të Policisë së Shtetit Zvicerian, Qendrave të Riintegritimit për Viktimat e Trafikut dhe IOM.

16 Shtator 2010 – Pjesëmarrje në takimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit, organizuar nga Ministria e Brendshme më 16 Shtator 2010.



12 Tetor 2010 – Pjesëmarrje në takimin e parë konsultativ me partnerët në kuadër të implementimit të programit: “Zhvillimi i sistemit mbështetës për adresimin e dhunës kundra grave”, implementuar nga Rrjeti kundër Dhunës Gjinore dhe Trafikimit, mbështetur financiarisht nga UN Trust Fund.

14 Tetor 2010 – Pjesëmarrje në takimin konsultativ me organizata të shoqërisë civile mbi “Të drejtat e njeriut dhe pjesëmarrja në Shqipëri” organizuar nga UN.

15 Tetor 2010 – Pjesëmarrje në takimin me përfaqësues të Departamentit të Shtetit Amerikan.

21 Tetor 2010 – Pjesëmarrje në workshop-in “Zhvillime dhe sfida të kuadrit ligjor shqiptar, për organizatat jo-fitimprurëse që operojnë në fushat sociale dhe atë të shëndetit”, organizuar nga Shoqata Ryder.

26 Tetor 2010 – Pjesëmarrje në takimin për shkëmbim idesh organizuar nga UNDP në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Vullnetarizmit.

27 Tetor 2010 – Pjesëmarrje në tryezën e rrumbullakët “Fuqizimi i grave të zonave rurale në Shqipëri: prespektiva ekonomike dhe sociale”, organizuar nga Insituti për Demokraci dhe Ndërhyrje në bashkëpunim me Qendrën e Aleancës Gjinore për Zhvillim.

30 Nëntor 2010 – Pjesëmarrje në takimin e raportit të tretë periodik të Qeverisë së Shqipërisë për implementimin e CEDAW, organizuar nga Aleanca Gjinore për Zhvillim.

2 Dhjetor 2010 – Pjesëmarrje në konferencën “Roli i ofruesve të shërbimeve shëndetësore në adresimin e problemeve të dhunës me baza gjinore”.

3-4 Dhjetor 2010 – Pjesëmarrje në konferencën e organizuar në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Vullnetarizmit.

Pjesëmarrje në aktivitetin “Liberalizimi i Vizave dhe problemet e trafikimit të qënieve njerëzore” organizuar nga Lëvizja Europiane Shqipëri.

17 Dhjetor 2010 – Pjesëmarrje në “Debatin e tretë të të Drejtave të Njeriut në Shqipëri”, organizuar nga CRCA.



7. PASQYRA FINANCIARE

Pasqyra financiare e bilancit 31 Dhjetor 2010

(Në LEK)

Aktivet	2010 (në lek)	2009 (në lek)	Diferencë (në lek)
Aktive të trupezuara neto	3,076,849	2,281,320	795,529
Inventari	141,248	28,929-	112,319
Të ardhura për tu marrë	321,431	1,108,755	(787,324)
Arka dhe banka	9,105,446	27,863	9,077,583
TOTALI	12,644,974	3,446,867	9,198,107

DETYRIME DHE ASETE NETO

Grante, subvencione dhe asete neto	2,594,235	2,126,800	467,435
Detyrime:			
LLogari te pagueshme dhe Accounts payable (401, 421, 431, 442, 445,405)	321,431	1,108,755	(787,324)
Diferencë burimesh të papërdorura	9,729,308	211,312	9,517,996
Total	12,644,974	3,446,867	9,198,107

Shënim: Pasqyrat financiare “Të Ndryshëm & Të Barabartë” për vitin 2010 janë audituar nga një Kompani e Pavarur Auditimi AI & EI - AUDITORS sh.p.k, , në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit (ISAs)



Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve 1 Janar – 31 Dhjetor 2010 (Në LEK)

	31 Dhjetor 2010 (ne lek)	31 Dhjetor 2009 (ne lek)
Te ardhura korente		
Donacione	32,792,339	15,870,090
Te tjera	112,319	-
Total	32,904,658	15,870,090
Shpenzime korente		
Paga	7,134,565	4,395,749
Sigurime shoqerore	1,927,799	1,276,402
Amortizimi vjetor	1,625,698	
Shpenzime te tjera	14,324,298	9,986,627
Total Shpenzime	25,012,360	15,658,778
Interest expenses	-	-
Total	25,012,360	15,658,778
Diference burimesh	7,892,298	211,312
Rimarrje kuote e amortizimit	1,625,698	-
Rritje e aseteve neto	9,517,996	211,312
Asete neto ne fillim te periudhes	211,312	-
Asete neto ne fund te periudhes	9,729,308	211,312-